



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**Raport i Akreditimit Institucional Periodik të Akademisë
“Ivodent”**

Shkurt 2022

GRUPI I VLERËSIMIT:

1. Prof. Asoc. Çlirim Duro Kryetar
2. Prof. Asoc. Teuta Pustina Anëtar

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	Error! Bookmark not defined.
Konteksti i këtij vlerësimi	Error! Bookmark not defined.
Raporti përmbledhës	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	Error! Bookmark not defined.
Gjetje	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e vlerësimit 2: Burimet	Error! Bookmark not defined.
Gjetje	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula	Error! Bookmark not defined.
Gjetje	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi ...	Error! Bookmark not defined.
defined.	
Gjetje	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	Error! Bookmark not defined.
Gjetje	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Lista e evidencave	Error! Bookmark not defined.
Lista A e evidencave	Error! Bookmark not defined.
Lista B: Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës	Error! Bookmark not defined.

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle Akademia “Ivodont” përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të caktuar nga ASCAL.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Akademia “Ivodont”, por edhe për t’iu ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruarit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë; standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar ASCAL-it dhe Bordit të Akreditimit

një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur
- Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht
- Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht
- Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.

Në kuadrin e procesit të përpilimit të raportit, ASCAL-i ka siguruar ekspertë mbështetës për grupin e vlerësimit duke siguruar që grupi t’i mbështesë Gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia "Ivodont" është një institucion privat i arsimit të lartë, i riorganizuar nga Kolegji Profesional Privat "Ivoclar Vivadent & Partners", i licensuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.178, datë 19.02.2009[A. I.1]. Kolegji Profesional Privat "Ivoclar Vivadent & Partners" u akreditua për një periudhë 6-vjeçare me Urdhër të Ministrit Nr. 328, datë 15.08.2013, [A. I.2] dhe më pas u riorganizua në Akademinë "Ivodont" me Urdhër Nr. 598, datë 21.12.2016 [A. I.3]. Që prej hapjes së tij, ky Institucion ka ofruar vetëm një cikël të parë studimesh në nivelin Bachelor në degën "Teknikë e Lartë Dentare". Në 2014 u pezulluan aktivitetet e Akademisë "Ivodont" (AI) (Vendim i Kryeministrit Nr. 540, datë 06.08.2014). Kjo periudhë 2-vjeçare pezullimi shkaktoi ndikim negativ në performancën e Institucionit, vështirësi në lidhje me riorganizimin në përputhje me kërkesat e ligjit, dhe gjithashtu në numrin e studentëve. Veprimtaria akademike gjatë këtyre dy viteve u përqendrua kryesisht në përfundimin e studimeve për studentët ekzistues, pa pasur mundësinë për të regjistruar studentë të rinj.

Pas heqjes së urdhrat të pezullimit në vitin 2016, Kolegji Profesional Privat "Ivoclar Vivadent & Partners" ndryshoi organizimin profesional, profilin akademik dhe emrin e tij. Në shtator 2016, u miratua një Statut i ri dhe organizimi i institutit u ndryshua nga "Kolegji Profesional" në "Akademi" me emrin e ri "Ivodont". Kjo bëri të mundur që të gjitha aktet e brendshme rregullatore të ishin në pajtueshmëri me organizimin e ri institucional dhe ligjet në fuqi. I gjithë procesi u zhvillua në përputhje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me të cilën Akademia "Ivodont" ka nënshkruar një marrëveshje (Nr. 5069, datë 06/06/2019), ku Akademisë i lejohet të ketë një numër stafi akademik më të ulët se sa 7.

Në vitin 2019, institucioni filloi procesin e akreditimit, i cili u finalizua në janar 2020 me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 5, datë 24.01.2020. Mbështetur në këtë vendim, AI-së iu desh t'i nënshtrohej procesit të riakreditimit institucional. Bazuar në këtë akreditim, AI-ja u akreditua për 2 vjet me shtatë rekomandime [www.ascal.al]. Periudha e procesit të akreditimit ishte 16.09.2021 - 23.02.2022.

Akademia "Ivodont" i ka dërguar ASCAL-it dhe BA-së, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit paraprak [D]. Sikundër përmendet në plan, të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga AI-ja përqendrohen jo vetëm në zbatimin e rekomandimeve, por edhe në rritjen e cilësisë së funksionimit të institucionit dhe zhvillimit të tij të mëtejshëm në përputhje me strategjinë institucionale të zhvillimit të AI-së. GVB-ja ka përgatitur dhe ka paraqitur një raport të hollësishtëm me informacione për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në vendimin e BA-së [D].

Institucioni përmendi vështirësitë gjatë dy viteve të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, që në shumë raste ka ndikuar te zbatimi i rekomandimeve. Shumica e rekomandimeve janë adresuar nga institucioni [D] dhe në të njëjtën kohë, ne e nxisim institucionin që të vazhdojë procesin e përmirësimit të cilësisë në AI.

Raporti përmbledhës

Akademia “Ivodont” është një institucion privat i arsimit të lartë, i cili e filloi veprimtarinë e tij

në vitin 2004 dhe u licencua në vitin 2009 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencën, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Akademia “Ivodont” është ndër Institucionet e para private në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë, aktualisht i organizuar në një fakultet: Fakulteti i Teknikave Dentare. Akademia “Ivodont” përbëhet nga njësi kryesore (fakulteti), 2 departamente dhe një qendër kërkimore [A. I.18] me një staf akademik prej 15 punonjësish. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, akademia përqendrohet në një fushën e shkencave dentare dhe materialeve që përdoren në dentistri. Që prej vitit 2019, AI-ja ka nënshkruar me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (aktualisht Ministria e Arsimit dhe Sportit - MAS) një marrëveshje të veçantë, sipas së cilës, akademia përjashtohet nga përmbushja e detyrimit ligjor të 7 punonjësve akademikë për njësi bazë [A. I.9].

Aktualisht Akademia ofron 3 programe studimi: një program 2-vjeçar me karakter profesional në “Teknikë Dentare”, një program i ciklit të parë, Bachelor në “Teknikë Dentare”, dhe një program studimi i ciklit të dytë, Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare”. Akademia ka të drejtën të ofrojë programe në të tria ciklet e studimit dhe, sikundër parashikohet në strategjinë e zhvillimit, pas konsolidimit të dy cikleve të para, institucionit do të përqendrohet në ciklin e tretë për të ofruar një program të përbashkët me institucione partnere. [A.I.12]. Aktualisht në AI studiojnë rreth 100 studentë në ciklin e parë, të dytë dhe në programin profesional.

Në raportin e vlerësimit paraprak u dhanë 10 rekomandime për akademinë, ndërsa Bordi i Akreditimit, me vendim Nr. 5, datë 24.01.2020, dha 7 rekomandime

Mbështetur në raportin paraprak të akreditimit, gjykimet përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi ishin: Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij ishin përmbushur pjesërisht, Standardet për Burimet ishin përmbushur pjesërisht, Standardet për Kurrikulën ishin përmbushur kryesisht, Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin ishin **përmbushur kryesisht**, Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre ishin përmbushur kryesisht.

Sikundër u përmend më sipër, institucioni dha informacione për shtatë rekomandimet e vendimit të BA-së [D] dhe adresoi shumicën prej tyre.

R1: Institucioni duhet të standardizojë procedurat e komunikimit ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit për rritjen e transparencës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori në konsideratë që organizimi i brendshëm në AI është në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme. AI-ja zbaton rregullisht funksionimin e organeve kolegiale. Duke marrë parasysh faktin se institucioni është i vogël, aktivitete të ndryshme kryhen përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, çka nuk e prek funksionimin e organeve dhe strukturave qeverisëse.

R2: Institucioni duhet të ngrejë mekanizma për ofrimin e mbështetjes financiare për zbatimin e aktiviteteve për zhvillimin/kualifikimet e stafit, si dhe duhet të krijojë procedura standarde për këtë qëllim.

Pavarësisht vështirësive që ka kaluar, një ndër prioritetet kryesore të institucionit ka qenë kualifikimi i mëtejshëm i stafit akademik përmes organizimit të konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me universitete të mirënjohura. Stafi është mbështetur në aktivitete të ndryshme shkencore, si: konferenca, simpoziume, kongrese të organizuara në AI ose jashtë vendit, të cilat kanë vazhduar edhe gjatë pandemisë; botime shkencore, për të cilat stafit akademik i është dhënë mundësia e mbështetjes financiare nga AI-ja për tarifat e botimit, hartimin e teksteve të ndryshme, në formën e librave ose leksioneve të shkruara që e njohin këtë angazhim në funksion të institucionit, duke i konvertuar në orë pune, ngritjen e stafit në detyrë përmes sistemit të ngritjes në detyrë, pozicioneve, çmimeve dhe honorareve, viteve sabbatike, etj.

Për vitet në vijim, Akademia ka planifikuar mbështetjen dhe kualifikimin e stafit individualisht, duke qenë se programet e studimit të ciklit të tretë nuk ofrohen ende nga institucioni. Aktualisht ky proces mundësohet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit, me angazhimin e stafit akademik me përvojë në krijimin dhe menaxhimin e projekteve të kërkimit shkencore, duke kombinuar stafin e ri me stafin me përvojë, etj. Një shembull është programi dypalësh i Shkencës dhe Teknologjisë Itali - Shqipëri në bashkëpunim me Institutin e Kristalografisë.

R3: Institucioni duhet të sigurohet se buxheti hartohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, me propozime që paraqiten nga departamentet e fakultetit.

Ne gjetëm një procedurë të qartë për hartimin e buxhetit. Rektorati harton planin e zhvillimit strategjik të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë, kryesorja në institucion, si dhe atyre administrative, dhe ia paraqet për miratim Senatit dhe Administratorit, si dhe një anëtar të Rektoratit, bazuar në propozimet e njësive, harton projektbuxhetin vjetor të AI-së. Përmendet se AI-ja është një institucion i vogël, ndaj komunikimi, ndërveprimi dhe funksionimi i brendshëm ndërmjet organeve, njësive dhe stafit kryhen përmes takimeve të drejtpërdrejta. Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në Akademinë "Ivodont" mbështeten në një plan veprimi të hartuar nga shoqëria që mbështet institucionin.

R4: Institucioni duhet të kryejë vazhdimisht auditime të jashtme financiare.

Mbështetur në marrëveshje, po zhvillohej një proces auditimi mbi menaxhimin financiar. Shoqëria ka hartuar një raport që i është vënë në dispozicion Bordit të Administrimit dhe stafit akademik të institucionit. Në të njëjtën kohë, auditet nga MAS-i dhe raportet periodike janë pjesë e dokumentacionit të arkivuar në institucion.

R 5: Institucioni duhet të kryejë veprime për të rritur bashkëpunimin midis stafit akademik dhe të përcaktojë prioritetet të qarta kërkimore dhe fusha shkencore, si dhe duhet të punojë vazhdimisht për t'i zbatuar ato prioritetet kërkimore institucionale.

Veçanërisht gjatë dy viteve të fundit, institucioni ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt kërkimit shkencor, duke zbatuar prioritetet e kërkimit shkencor të parashikuara në strategjinë e zhvillimit të Institucionit. Gjatë takimeve me drejtuesit e lartë u përmend se ndërkombëtarizimi është prioritet kryesor, i cili do të arrihet përmes lidhjes së partneriteteve

të qëndrueshme ndërkombëtare, intensifikimit të programit të mobilitetit afatshkurtër dhe afatgjatë të studentëve dhe profesorëve, rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor duke promovuar kërkimet e përbashkëta në fusha me interes ndërkombëtar, krijimit të një mjedisi mundësues, pjesëmarrjes së studentëve dhe profesorëve si dhe organizimit të konferencave shkencore ndërkombëtare, dhe zgjerimit të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare, duke ofruar asistencë teknike në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Ne i kuptojmë vështirësitë që ka hasur institucioni në shtimin e aktiviteteve kërkimore dhe rritjen e pjesëmarrjes në projekte për shkak të COVID-19. Ndërkaq, ne besojmë se numri i ulët i stafit akademik do të ndikojë mbi pjesëmarrjen në projekte. Në këtë kontekst, po zbatohen rekomandimet e mësipërme.

R6: Institucioni duhet të hartojë një politikë për informimin dhe orientimin e nxënësve të shkollave të mesme rreth Institucionit dhe programeve të tij të studimit, përmirësimin e infrastrukturës për studentët me nevoja të veçanta, si dhe përfaqësimin gjithëpërfshirë të studentëve në strukturat apo organet qeverisëse të Institucionit.

Akademia "Ivodont" ka përgatitur një dokument të veçantë për procedurat që ndiqen nga institucioni në lidhje me orientimin e studentëve të rinj. Aktivitetet promovuese dhe informuese me të diplomuarit kanë qenë të kufizuara gjatë këtyre dy viteve pandemi. Megjithatë, institucioni iu është bashkuar ditëve të informimit, që janë një nga aktivitetet e zhvilluara nga MAS-i me të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Politika për informimin dhe orientimin e nxënësve të shkollave të mesme rreth Institucionit dhe programeve të tij të studimit, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës për studentët, është publikuar në faqen zyrtare të institucionit. www.ivodont.org.

R7: Institucioni duhet të kryejë veprime për të krijuar një mjedis bashkëpunues dhe konstruktiv, që mundëson debate dhe diskutime ku përfshihen të gjitha organet e institucionit. Evidencat mbështetëse ofrojnë shumë informacione në lidhje me mbledhjet dhe veprimtaritë e strukturave të institucionit. Të qenët institucion i vogël mundëson bashkëpunimin midis stafit.

Një Grup Pune i Brendshëm Vetëvlerësimi, në përbërje të të cilit kishte 5 përfaqësues të institucionit, duke përfshirë një përfaqësues të studentëve, hartoi një Raport Vetëvlerësimi **[AE1.30]**. Faza e vlerësimit të dokumentacionit u zhvillua gjatë periudhës 6-7 dhjetor. Atyre iu mundësuan dokumente, statute dhe rregullore të brendshme të Akademisë, bashkërisht me të dhënat statistikore dhe raportet përkatëse. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në institucion, përpara përfundimit. Senati Akademik autorizoi lëshimin e raportit përfundimtar dhe dërgimin e tij pranë ASCAL-it.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy vlerësues, njëri nga jashtë Shqipërisë, ndërsa tjetri anëtar stafi nga një institucion shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit, i vënë në dispozicion nga Agjencia shqiptare e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit, evidencat mbështetëse, si dhe dokumentacionin shtesë që kishte kërkuar gjatë mbledhjeve. Larmia e informacionit mbështetës të ofruar nga Akademia, i dha mundësinë grupit të njëjti me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe

veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor ndaj Ministrisë, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumëve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, me alumni, si dhe partnerë të jashtëm gjatë dy ditëve që zhvilluan mbledhje. Diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet janë mbajtur procesverbale dhe janë referuar në këtë raport.

Për shkak të pandemisë së COVID-19, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm njeh vështirësitë dhe angazhimin e institucionit gjatë këtij vlerësimi, si dhe bashkëpunimin me Grupin gjatë të gjitha fazave të procesit. Në veçanti, grupi i vlerësimit përgëzon punën e Grupit të Vetëvlerësimit për mundësimin e dokumentacionit dhe informacionit gjithëpërfshirës të bazuar te provat, si dhe stafin akademik e studentët për pjesëmarrjen në takime.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm falënderon ASCAL-in, Menaxherin e Vlerësimit, dhe drejtorin për mbështetjen në këtë proces. Grupi i vlerësimit përbëhej nga Çlirim Duro (Kryetar) dhe Teuta Pustina (Anëtar).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se:

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht**. Për të arritur në këtë gjykim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pohime në lidhje me punën e bërë nga institucioni për të zbatuar rekomandimin e Bordit të Akreditimit për standardizimin e procedurave të komunikimit të brendshëm. Krahas kësaj, ne i kuptojmë vështirësitë që kanë hasur strukturat, stafi akademik dhe studentët gjatë takimeve në pandemi, si dhe për shkak të kohës së shkurtër të akreditimit të mëparshëm.

Standardet për Burimet **janë përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, identifikoi një pikë të dobët dhe dha rekomandimin përkatës, si dhe bëri dy pohime. Një shembull i mirë është raporti staf/studentë, që është rreth 1/10, çka kryesisht shkaktohet nga numri i ulët i studentëve. AI-ja has vështirësi me rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar. Kjo ndikon në strategjinë e ngritjes në detyrë të stafit akademik në lidhje me titujt akademikë. Për aq kohë sa institucioni ka marrëveshje me ministrinë, ne mendojmë se në këtë fazë, kjo marrëveshje mbulon detyrimet ligjore për stafin akademik. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se numri i ulët i stafit akademik prek aktivitetet e tjera të institucionit. Pohimi është bërë në lidhje me masat e ndërmarra nga institucioni për ndërtimin e laboratorëve të rinj, si dhe infrastruktura është përmirësuar me hapësira të reja.

Standardet për Kurrikulën **janë përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe bëri pohime. Karakteristikat e praktikës së mirë në lidhje me infrastrukturën laboratorike, orientimin e programeve të studimit me praktikë, bashkëpunimin me institucionet për trajnime praktike, tregun e punës, etj. Shqetësimet lidhen me mungesën e programeve të Masterit ose PhD-së

për të rritur aktivitetet dhe produktet kërkimore. Pohimi shoqërues lidhet me punën që është bërë për përmirësimin e programit, hapjen e programit të Masterit Profesional, dhe fokusin e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin **janë përmbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi tri pika të dobëta dhe dha rekomandimet përkatëse, dhe bëri pohime. Pikat e dobëta lidhen me mungesën e projekteve kërkimore dhe buxhetet e vogla në nivelin e departamenteve. Rekomandimet shoqëruese përqendrohen te mënyra se si institucioni duhet të rritë buxhetin për kërkimet dhe të promovojë pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore dhe mobilitet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se institucioni ka bërë progres në dokumentimin e aktiviteteve kërkimore.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre **janë përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe bëri një pohim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon progresin e bërë me bibliotekën online, si dhe mbështetjen e studentëve në studime dhe gjetjen e një vendi pune. Ne rekomandojmë një buxhet të dedikuar për rritjen e fondit të bibliotekës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikat e mira si më poshtë:

- Institucioni ka laboratorë dhe infrastrukturë të dedikuar për teknikat dentare, që iu mundësojnë studentëve formim të mirë profesional **[Kapitulli III Standardi VII.3]**.
- AI-ja zbaton një politikë të hapur burimesh njerëzore për punësimin dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar akademik dhe administrativ **[Kapitulli III Standardi IV.1]**.
- Digjitalizimi i teknikave dentare që përdoren në mësimdhënie dhe laboratorë kërkimorë.
- AI-ja ka krijuar bashkëpunim të mirë me laboratorët dentarë privatë në Shqipëri dhe Gjermani (alumni të suksesshëm të AI-së) për të mbështetur studentët gjatë formimit të tyre praktik, çka është kyç për punësimin e tyre në të ardhmen **[Kapitulli III Standardi III.3]**.
- Programet e studimit në AI orientohen për nga praktika, dhe përditësohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës për specialistët në teknika dentare **[Kapitulli I Standardi I.10, Kapitulli I Standardi I.9, Kapitulli I Standardi I.12]**.
- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se institucioni ka infrastrukturë laboratorike bashkëkohore me pajisje moderne dhe hapësira pune për praktikë dhe kërkime **[Kapitulli I Standardi II.1]**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Mungesa e konferencave shkencore që organizohen në AI rreth temave të teknikave dentare **[Kapitulli II Standardi I.2].**
- Mungesa e marrëveshjeve me universitete të tjera për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit **[Kapitulli II Standardi I.3].**
- Mungesa e procedurave të qarta dhe të hollësishme për shpërndarjen e fondeve të kërkimit **[Kapitulli II Standardi I.2].**

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon institucionit që të hapë programe të reja të Masterit Shkencor, në përputhje me strategjinë dhe profilin e tij **[Kapitulli I, Standardi I.2].**
- Institucioni duhet të shtojë aktivitetet e stafit akademik dhe studentëve me pjesëmarrje në projekte dhe kërkime brenda dhe jashtë Shqipërisë **[Kapitulli II Standardi I.2].**
- Institucioni duhet të nënshkruajë marrëveshje me universitete të tjera për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit **[Kapitulli II Standardi I.3].**
- Për shkak të zgjerimit të strukturës së tij, institucioni duhet të krijojë një procedurë të qartë dhe të hollësishme për shpërndarjen e fondit të kërkimit **[Kapitulli II Standardi I.2].**
- Bashkëpunimi me alumnit dhe Zyrën e Alumnive duhet të koordinohet përmes një dokumenti, që parashton funksionin, kontributin dhe angazhimin e tyre **[Kapitulli I Standardi III.3]**
- Institucioni duhet të alokojë buxhet të dedikuar për të rritur numrin e librave, botimeve dhe buletineve shkencore në format të shtypur në bibliotekë **[Kapitulli I Standardi III.5]**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Institucioni ka bërë progres me standardizimin e komunikimit ndërmjet strukturave dhe zyrave në institucion, duke përfshirë Senatën akademik, Bordin e Administrimit, Rektoratin, etj. **[Kapitulli III Standardi II.3].**
- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon hapat që po ndërmerren për të përdorur teknologjinë e mësimin në distancë gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 **[Kapitulli III, Standardi VII.1]**
- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon përpjekjet që po bëhen për të përmbushur kërkesat e tregut për teknikë dentare digjitale, duke hapur një program të ri Masteri Profesional në Teknika Dentare Digjitale **[Kapitulli I, Standardi I.3].**
- Diploma e Bachelorit në “Teknika të Larta Dentare” e Akademisë “Ivodent” u njoh zyrtarisht në Gjermani, në dhjetor 2021 **[Kapitulli 1, Standardi I.10].**

- AI-ja përfshihet në rrjete ndërkombëtare kërkimi, duke pritur anëtarët e Unionit Ndërkombëtar të Kristalografëve për Shqipërinë dhe Kosovën (Shoqata e Kristalografëve të Shqipërisë), si dhe duke dërguar anëtarët e saj në disa Veprimtari të programit COST **[Kapitulli II Standardi I.3]**.

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Akademia “Ivodont” (AI) ka një statut gjithëpërfshirës (miratuar në vitin 2016), **[A.I8]** që është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri dhe misionin dhe objektivat e planit strategjik **[A.I12]** të institucionit. Statuti përdoret si bazë për të gjitha aktivitetet dhe rregulloret e institucionit. Rregullorja e Përgjithshme **[A.I17]**, është në përputhje me të, njësoj si të gjitha rregulloret e tjera të Fakultetit **[A.I55]**. Rregullorja e Përgjithshme **[A.I17]** parashikon organizimin e AI-së, funksionimin e organeve qeverisëse, përgjegjësitë e stafit akademik dhe administrativ, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, si dhe procedurat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Krahas kësaj, ka rregullore për çdo program studimi në ciklin e parë dhe të dytë **[A.I109; A.I110; A.I121]**. AI-ja arrin të përshtatet dhe të përmirësojë statutin dhe rregulloret e saj sipas nevojës, që vërtetohet qartësisht nga rregulloret e reja për sigurinë në lidhje me COVID-19 **[A.I111; BM1; BM5]** dhe udhëzimet për mësimdhënien dhe mësimnxënien online **[A.I112; A.I76; A.I94]**. Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me Statutin e tij. **[Kapitulli III Standardi I.1]**.

1.2 AI-ja është një institucion me rreth 100 studentë, dhe si i tillë, ka marrëveshje me MAS-në për staf të reduktuar. **[A.I9]** Struktura aktuale e institucionit është në përputhje me statutin e tij **[A.I8]**, çka parashtrohet qartësisht në organigramë **[A.I8; A.I18]** dhe kuptohet nga të gjithë punonjësit **[BM3; BM4, BM5]**. Gjatë diskutimeve me punonjësit u bë e dukshme se AI-ja ka një strukturë të efektshme menaxhimi, sipas statutit **[A.I8; A.I18]** që përfshin Bordin e Administrimit, Rektoratin, Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Dekanatin, dhe Asamblenë e Personelit Akademik. Autoritetet kryesuese janë Rektori, Administratori, Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve **[A.I18; BM1; BM4; BM5]**. Sipas statutit **[A.I8]**, Senati Akademik ka përgjegjësi për miratimin e planit strategjik **[A.I53]** dhe planeve vjetore të institucionit, duke përfshirë miratimin e programeve të reja të studimit, që propozohen nga departamentet. Rektorati është përgjegjës për hartimin e planit strategjik, duke marrë parasysh propozimet e fakulteteve, departamenteve dhe administratorit, si dhe zbatimin e vendimeve të Senatit **[A.I18; A.I53; BM1]**. Krahas kësaj, Rektorati i paraqet buxhetin **[A.I99]** Senatit për miratim **[BM1; BM4]**. Përgjegjësit e departamenteve paraqesin propozime për programe të reja, të cilat diskutohen në nivel fakulteti përpara se të kostohen dhe të miratohen në Senat **[A.I86]**. Bordi i Administrimit harton buxhetin vjetor mbështetur në propozimet e departamenteve dhe fakulteteve, dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të institucionit **[A.I22]**. Këshilli i Etikës është përgjegjës për shqyrtimin e çështjeve etike në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin, rregullohet nga Statuti **[A.I8]** dhe Rregullorja e vet **[A.I98]**, si dhe duhet të ofrojë evidenca

për veprimtaritë e veta **[BM5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon progresin në mënyrën e funksionimit të të gjitha strukturave qeverisëse dhe administrative krahasuar me akreditimin e mëparshëm **[EER 2020, faqja e ASCAL-it]**, dhe gjykon se institucioni është i organizuar në mënyrë të tillë që garanton menaxhim të efektshëm. Gjatë mbledhjeve me stafin akademik **[BM3]**, stafin mbështetës **[BM5]**, dekanët, përgjegjësit e departamenteve, dhe drejtuesit e lartë **[BM4]** u bë e dukshme se AI-ja ka procedurë të mirëpërcaktuara vendimmarrëse, që përfshijnë angazhimin e plotë të stafit përkatës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon se vendimmarrja realizohet në përputhje me legjislacionin, që garanton objektivitet, transparencë dhe pjesëmarrje të të gjithë aktorëve të institucionit në këtë proces **[Kapitulli III Standardi I.2]**.

1.3 Rregulloret e brendshme përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e Senatit dhe organeve të tjera kolegjinale, të cilat në shumicën e rasteve, nuk kanë vetëm kompetenca propozuese, por edhe vendimmarrëse. Senati dhe stafi akademik mbledhen periodikisht, në përputhje me rregulloret përkatëse. Mbledhjet planifikohen paraprakisht sipas Statutit **[A.18]** ose programohen mbledhje të tjera sipas nevojës, ndërsa agjendat dhe procesverbalet qarkullohen sipas rastit **[A.128; A.129; A.130]**. Nga ana tjetër, Këshilli i Etikës përqendrohet te çështjet që lidhen me veprimtarinë etike të AI-së. Dekanati është institucioni lidhës midis Rektoratit dhe Njësive Bazë: miraton prioritetet e identifikuara nga njësitë bazë në lidhje me programet e studimit, kriteret e pranimit, dhe prioritetet e zhvillimit **[A.128; A.153]**. Vendimet e organeve kolegjinale (Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati) protokollohen dhe iu kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me objektin e vendimit **[BM1; BM4]**. Studentët kontribuojnë në debate konstruktive falë pjesëmarrjes së tyre në Senat dhe Komitetin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët **[BM4]**. Si njësi bazë, mbledhjet e Departamenteve përqendrohet te çështjet që lidhen me detyrat e mësimdhënies, programet e studimit, monitorimin e veprimtarive të kërkimit shkencor që zhvillohen nga anëtarët e departamentit, monitorimin e aspekteve të ndryshme të marrëdhënieve me studentët, i cili adresohet gjatë diskutimeve me stafin akademik, falë pjesëmarrjes së përfaqësuesve të studentëve në mbledhjet e Senatit dhe Departamenteve. Mbledhjet e departamentit drejtohen nga përgjegjësi i departamentit **[A.130]**. **[Kapitulli III Standardi I.3]**.

1.4 AI-ja vepron në kuadër të Statutit **[A.18]** dhe në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, i cili parashikon lirinë akademike. Ka strukturat e përshtatshme për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të veprimtarive, sipas organigramës **[A.118]**. Cilësia e monitorimit në AI është përgjegjësi e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) **[BM5]** sipas Vendimit të Rektoratit **[A.138]**. NJSBC-ja kryen monitorim të vazhdueshëm të funksioneve akademike dhe administrative **[BM5; A.138]**. Ekspertët e jashtëm japin një këndvështrim objektiv, çka i shton vlera procesit **[BM5]**. AI-ja ka lidhur partneritete të shëndosha me universitetet dhe institucionet vendase dhe ndërkombëtare **[A.162; A.163; A.164; A.165; A.166; A.167; A.171; A.181; BM6]**. Komiteti i mbështetjes për zhvillim dhe kërkim shërben si një organ që i mundëson stafit akademik informacione rreth thirrjeve të hapura për projekte dhe financim, si dhe rreth procedurave të aplikimit **[A.118; BM5]**. **[Kapitulli III Standardi I.4]**.

1.5 Plani i Zhvillimit Strategjik 2018 - 2023 **[A.I12]** në AI është në përputhje me misionin dhe qëllimin **[A.I8]** e institucionit dhe ka nëntë prioritete strategjike: Konsolidim financiar, rritje e cilësisë së aktiviteteve akademike, krijim i një mjedisi pozitiv pune dhe të nxëni, zhvillim i programeve të studimit dhe rritje e kapacitetit akademik, bashkëpunim dhe partneritet ndërkombëtar, partneritet me profesionistë dentarë, biznesin dhe komunitetin, garantim i zhvillimit të qëndrueshëm të institucionit, orientim në fusha të tjera, hapje e njësive dhe programeve të reja të studimit, zhvillim kërkimi, novacion dhe kërkim i avancuar shkencor. Plani u diskutua me stafin akademik, studentët dhe Bordin e Administrimit përpara se të miratohej me Senatin Akademik, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret **[A.I8; A.I12; BM1; BM3; BM4]**. Strategjia parashikon objektiva dhe mënyra të përshtatshme për të arritur rezultatet e pritshme. Një pjesë integrale e strategjisë është zhvillimi i infrastrukturës **[A.I101]** për të mbështetur zhvillimin e programeve të reja të studimit **[A.I106]**. Të gjitha këto janë propozuar në bazë të analizës së tregut të punës **[A.I56]**. Procesi i zbatimit të strategjisë dokumentohet kryesisht përmes raporteve vjetore analitike **[A.I37; A.I37.1; A.I37.2]** *[Kapitulli III Standardi I.5]*.

1.6 Në përputhje me Nenin 32 të Ligjit Nr. 80/2015, çdo vit akademik, AI-ja harton një raport vjetor, i cili i paraqitet MAS-it dhe botohet në faqen zyrtare të institucionit **[A.I37; A.I37.1; A.I37.2]**. Çdo njësi bazë e AI-së i paraqet raportin vjetor Rektoratit çdo fund viti akademik, i cili në vetvete është një model i vlerësimit të brendshëm të njësive. Senati, Rektorati dhe Bordi Administrativ diskutojnë dhe e miratojnë këtë dokument me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit **[RVV]**. Raporti paraqitet nga Rektorati gjatë mbledhjes së Senatit Akademik dhe bëhet objekt diskutimi midis stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve. Krahason performancën me vitet pararendëse dhe i mundëson Rektoratit, Senatit dhe Bordit të Administrimit që të marrin vendime të informuara strategjike dhe operacionale **[A.I32; A.I33; A.I34]**. Raporti vjetor e informon MAS-in rreth veprimtarisë akademike, situatës financiare, parashikon angazhimin e stafit akademik, ofron një vlerësim cilësie të studentëve dhe programeve të studimit, si dhe mundëson informacione rreth tarifave shkollore gjatë viteve të ardhshme *[Kapitulli III Standardi I.6]*.

1.7 AI-ja ka struktura të përshtatshme për ta arritur misionin dhe qëllimin e saj, sikundër përvijohet në Statut **[A.I8]** dhe vërtetohet nga stafi **[BM3; BM4; BM5]**. AI-ja ka një fakultet, dy departamente dhe një qendër kërkimore **[A.I18]**. Fryma e autonomisë parashikohet në Statut dhe pasqyrohet në rregulloret përkatëse, si: Rregullorja e Fakultetit **[A.I55]** dhe departamenteve **[RVV]**. Të gjitha rregulloret dhe procedurat miratohen nga Bordi i Administrimit dhe Senati. Liria akademike në mësimdhënie dhe kërkim parashikohet në Statut **[A.I8]**. AI-ja ofron programe studimi për të përmbushur misionin e saj, që plotësojnë kërkesat e tregut dhe janë në përputhje me planin e zhvillimit strategjik **[A.I12]** dhe prioritetet kombëtare. Këto programe studimi përfshijnë programin Bachelor në Teknika të Larta Dentare, programin Profesional në Teknika Dentare, Masterin Profesional në Teknika Digjitale Dentare, i cili është synim në tregun e punës **[A.I56]**. Strukturat mbështetëse përfshijnë sekretarinë, Bibliotekën dhe TI-në, sekretarinë akademike dhe të shërbimeve, Zyrën e Financave dhe Mbështetjes, Zyrën e Sigurimit të Cilësisë dhe

Bashkëpunimit, si dhe Këshillin Studentor **[RVV]**. Këto struktura paraqiten për inspektim në faqen e internetit të AI-së [www.ivodent.edu.al / www.ivodent.org], krahas shumë hollësive rreth Institucionit, programeve që ofron dhe organizimit të tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që AI-ja i ka strukturat e përshtatshme për ta përmbushur misionin dhe qëllimin e vet **[Kapitulli III Standardi II.1]**.

1.8 AI-ja ka disa organe vendimmarrëse, si: Senati, Bordi Administrativ, Rektorati, Këshilli i Etikës, dy komisione të përhershme për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Kërkimin, Asambleja e Personelit Akademik **[A.118]**, Dekanati dhe Këshillat Studentorë. Çdo organ ka përgjegjësi të veçanta, si për shembull Senati, i cili është përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe miratimin e buxhetit, sipas Rregullores së Senatit Akademik **[A.121; BM4]**. Bordi Administrativ mban përgjegjësi të veçantë për miratimin e buxhetit **[A.121; BM4]**, Rektorati zbaton planin e zhvillimit strategjik dhe kryen veprimtaritë e përditshme **[A.120; BM1]**, roli i Këshillit të Etikës përcaktohet në Rregullore, ndërsa Komisionet e Përhershme caktohen nga Rektorati **[A.138; BM1]** dhe kanë përgjegjësi specifike **[RVV]**. Edhe roli i Asamblesë së Personelit Akademik përcaktohet në Statut **[A.18]** dhe puna kryhet me efektshmëri, sikundër vërtetohet nga procesverbalet e mbledhjeve **[A.130]**. Dekanati merr vendimet e përshtatshme në nivelin e Fakultetit, ndërsa Këshillat Studentorë kanë role dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara **[A.18; A.1134; BM2; BM4]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimin se AI-ja ka organe menaxhimi që lehtësojnë vendimmarrjen duke mundësuar debate në bordet e institucionit **[Kapitulli III Standardi II.3]**.

1.9 Institucioni merr parasysh sugjerimet e studimeve të tregut të punës, që organizohen nga departamentet për programet e tyre përkatëse. Mbështetur në sugjerimet e studimeve të tregut të punës **[A.156; BM1; BM3; BM4; RVV]**, janë bërë propozime për të ndryshuar kurrikulën e disa programeve, si dhe për të hapur programe të reja. Një nga objektivat e Planit Strategjik është përditësimi i kurrikulave dhe kërkimi shkencor sipas nevojave të tregut. Zhvillimi i programeve të reja propozohet si përgjigje e shqyrtimit të këtyre informacioneve nga ekspertë të mirënjohur në institucion, si dhe dakordësohet përmes strukturës së komisioneve të sipërpërmendura. Krahas kësaj, AI-ja monitoron stazhin **[A.1128; A.1129]** dhe punësimin e studentëve pas diplomimit, me qëllim marrjen e informacioneve rreth punësueshmërisë nëpërmjet Zyrës së të Diplomuarve **[A.170; BM6]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se institucioni kryen studimin e tregut për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij **[Kapitulli III Standardi III.1]**.

1.10 AI-ja bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, vendore/rajonale për të përmirësuar mundësitë e studentëve për stazh **[RVV]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi shembuj të mirë bashkëpunimi me UPT-në në shkëmbimin e stafit, organizimin e veprimtarive shkencore, pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta kërkimore, DMCO për praktikën profesionale dhe mbështetjen e studentëve, AAC për bashkëpunimin shkencor ndërkombëtar, etj. **[BM6]** Veç kësaj, AI-ja iu është afruar institucioneve të ndryshme ndërkombëtare për mobilitetin e studentëve dhe stafit **[A.1129; A.158]**, veprimtari të përbashkëta, si dhe projekte kërkimore bashkëpunuese **[A.182]**. Grupi i Vlerësimit të

Jashtëm doli në përfundimin që AI-ja po zbaton një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti në nivelin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar **[Kapitulli III Standardi III.2]**.

1.11 Institucioni promovon dhe përmirëson veprimtaritë e mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të bashkëpunimit me projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. AI-ja bashkëpunon me një sërë institucionesh private dhe publike në Shqipëri, me qëllim që t'iu japë studentëve mundësinë që të marrin pjesë në stazhe, workshop-e dhe trajnime **[A.I60]**. Stafi nxitet që të marrë pjesë në konferenca dhe workshop-e **[A.I84]**, si dhe të bashkëpunojë me institucione të tjera të arsimit të lartë **[A.I13; A.I14; A.I62; A.I63; A.I64]**. Megjithatë, pandemia e shkaktuar nga COVID-19 i ka kufizuar ndjeshëm mundësitë këtë vit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimin që AI-ja zbaton një strategji bashkëpunimi me institucione të tjera mbështetëse, si dhe ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve në nivelin ndërkombëtar **[BM2; BM3; BM4]**. **[Kapitulli III, Standardet III.3, III.4]**.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi

Pohimi i veprimeve të ndërmarra.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Institucioni ka bërë progres me standardizimin e komunikimit ndërmjet strukturave dhe zyrave në institucion, duke përfshirë Senatin akademik, Bordin e Administrimit, Rektoratin, etj. **[Kapitulli III Standardi II.3]**.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Akademia “Ivodont” është e organizuar sipas Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme [A.I8], [A.I17]. Organigrama e IAL-së [A.I18] është e disponueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit [www.ivodont.edu.al / www.ivodont.org]. Sikundër shihet në organigramë dhe në numrin e përgjithshëm të stafit [A.I18; A.I88; A.I88.1; A.I88.2], AI-ja ka një strukturë të vogël dhe të efektshme në operim dhe administrim. Krahas kësaj, në sajë të numrit të vogël të studentëve, Akademia “Ivodont” ka lidhur një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit që i mundëson numër të reduktuar stafit, mjaftueshëm sa për të plotësuar nevojat e veta [A.I9]. Stafi akademik ose stafi administrativ në çdo njësi i nënshtrohet procesit të rekrutimit [BM3; BM4; A.I50]. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Departamentet e Fakultetit të Teknikave Dentare përlogarisin kërkesat e tyre për stafin me kohë të plotë dhe të pjesshme. Më pas, kërkesa për staf i dërgohet Rektorit me shkresë zyrtare. Rekrutimi organizohet sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, Kodit të Punës, Statutit dhe Rregulloreve të Përgjithshme të AI-së. Vendet vakante botohen në faqen zyrtare të institucionit [www.ivodont.edu.al / www.ivodont.org] për të qenë transparente dhe për të ndjekur procedurën. Për rekrutimin ngrihet një komision i posaçëm, i cili shqyrton aplikimet, kryen intervistat dhe njofton kandidatët fitues dhe jofitues. Si stafi akademik, ashtu edhe ai mbështetës merr kontratë pune që parashtron kushtet e punësimit [A.I89; A.I89.1; A.I89.2]. Për shkak të hapjes së një Programi të ri Profesional në “Teknika Dentare” [A.I45; A.I46] dhe një Masteri Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” [A.I43; A.I44], sikundër parashikohej në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit [BM1; BM7; A.I12], burimet njerëzore janë rritur me rreth 150% gjatë dy viteve të fundit [A.I88; A.I88.1; A.I88.2]. AI-ja e mbështet stafin në arritjen e gradave të tjera, si dhe ofron mbështetje financiare për stafin akademik që merr pjesë në konferenca shkencore dhe veprimtari kërkimore, në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik [BM1; BM3; BM5; A.I41; A.IA.I42; A.I95; A.I96]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që AI-ja zbaton një politikë të hapur burimesh njerëzore për punësimin dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar akademik dhe administrativ [Kapitulli III Standardi IV.1].

2.2 AI-ja angazhohet me zbatimin e politikave të integritit të punëdhënësve. Institucioni kujdeset që të ruajë një mjedis integruar dhe gjithëpërfshirës për stafin akademik dhe administrativ. Duke qenë se është institucion relativisht i vogël, anëtarët e stafit kontribuojnë në hartimin e strategjive, programeve të reja, etj., duke e bërë një vend pune ndërveprues [BM3, BM4, BM5, A.I43, A.I44, A.I47]. Ditët e Informimit organizohen për studentët aktualë dhe ata të ardhshëm, si dhe mbështeten nga stafi akademik dhe administrativ [BM2, BM3, A.I112, dhe A.I113]. IAL-ja organizon edhe veprimtari të tjera, si: promovime libri, festa kombëtare, dhe ceremoni diplomimi që mundësojnë bashkëpunimin ndërmjet stafit [BM3, BM4, A.I79, A.I79.1, A.I79.2, A.I79.3]. Për këtë arsye, konstatohet që AI-ja zbaton politikën e integritit të stafit akademik, mbështetës dhe administrativ [Kapitulli III Standardi IV.2].

- 2.3 AI-ja zbaton një plan trajnimi për të krijuar një mjedis pune, kur të gjithë, si studentët, ashtu edhe stafi, kanë mundësinë e kualifikimeve profesionale në fushat e tyre përkatëse dhe sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre **[BM2, BM3, BM6, A.141, A.1A.142, A.174, A.195, A.196]**. Trajnimi dhe forma të tjera të mbështetjes së stafit kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e performancës. Akademia, përmes një pale të tretë, kryen në fund të çdo viti akademik vlerësimin e punës dhe performancës së çdo anëtari stafi, nëpërmjet pyetësorit të studentëve si matës i cilësisë së mësimdhënies. **[BM5, A.124, A.140]** Për shkak të situatës së COVID-19, institucioni zhvilloi një sistem për mësimdhënien online. Stafi ka përfutur trajnim specifik në lidhje me mësimdhënien online. Janë shpërndarë manuale dhe udhëzues, si dhe janë zhvilluar disa trajnime në lidhje me teknikat e mësimdhënies online për përmirësimin e qasjeve të pedagogëve **[BM2, BM3, A.176, A.177, A.194, A.1111]**. **[Kapitulli III, Standardi IV.3]**.
- 2.4 Përpara pandemisë së COVID-19, AI-ja organizonte një sërë veprimtarish për të nxitur dialogun social midis stafit, studentëve dhe komunitetit, si: ndeshje volejbolli, ekskursionet, ndërjegjësim për dhurimin e gjakut, etj. **[BM2, A.179, A.179.1, A.179.2, A.179.3]** Edhe marrëveshjet e bashkëpunimit konsiderohen si kuadër për dialog social dhe shkëmbim njohurish, kulturash dhe përpjekjesh shkencore **[Kapitulli III Standardi IV.4]**.
- 2.5 Sekretaria mësimore, në bashkëpunim me të gjitha departamentet e tjera, bashkërendon veprimtaritë e institucionit sipas Statutit dhe Rregullores së Brendshme të Institucionit, si dhe drejtimeve nga Rektori dhe Administratori. Si stafi akademik, ashtu edhe ai administrativ nënshkruajnë kontrata individuale punësimi, që parashtrajnë rolet dhe përgjegjësitë e punëmarrësit dhe punëdhënësit **[BM3, BM4, A.189, A.189.1, A.189.2]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimin që AI-ja zbaton rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse **[Kapitulli III Standardi II.2]**.
- 2.6 Akademia "Ivodont" garanton qëndrueshmëri financiare përmes tarifave studentore dhe mbështetjes së shoqërisë themeluese, që ka anëtarë të Bordit të Administrimit të institucionit. Buxhetet përgatiten duke marrë parasysh nevojat e njësive, sipas programit dhe rregulloreve të AI-së. Më pas buxheti miratohet nga Senati dhe së fundi, nga Bordi i Administrimit **[BM1, BM4, BM5, A.123, A.136, A.186]**. Për këtë arsye, institucioni e harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara **[Kapitulli III Standardi VI.1]**.
- 2.7 Sipas Statutit, administratori është përgjegjës për zbatimin e procedurave të sakta financiare. Zyra e Financës e ushtron veprimtarinë e saj sipas rregullores përkatëse dhe i kryen funksionet e nevojshme, si pagesat, si dhe përgatit pasqyrat financiare. Administratori përgatit periodikisht një raport financiar për Bordin e Administrimit, me qëllim që të garantohet zbatimi i buxhetit sipas planeve dhe të bëhen përshtatjet sipas nevojës **[BM4, A.123]**. Krahas kësaj, AI-ja ka punësuar një palë të tretë që harton një raport auditimi financiar, i cili ofron informacione rreth politikave dhe tarifave të paguara nga studentët dhe përdorimit të tyre **[A.136]**. **[Kapitulli III Standardi VI. 2]**.

- 2.8 Administratori, Zyra e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse e monitorojnë pozicionin financiar vazhdimisht dhe raportojnë përpara Bordit çdo vit. Edhe raporti i audituesve të jashtëm i paraqitet Bordit të Administrimit, krahas pasqyrave financiare. Këto dokumente i paraqiten edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Raportet vjetore lidhen ngushtësisht me pozicionin financiar dhe objektivat institucionale, si dhe garantojnë që burimet njerëzore dhe fizike reflektohen në pasqyrat financiare **[BM4, A.I23, A.I36]**. AI-ja i raporton vazhdimisht MAS-it **[A.I37, A.I37.1, A.I37.2]**. **[Kapitulli III Standardi VI. 3]**.
- 2.9 AI-ja ka një faqe interneti gjithëpërfshirëse [www.ivodent.edu.al / www.ivodent.org], e cila përmban hollësi në lidhje me strukturën akademike, programet e ofruara, kërkimin, shërbimet, lajmet dhe median. Veç kësaj, Akademia “Ivodont” përdor edhe kanalet e saj në media sociale për të ndërvepruar me studentët në Facebook, Instagram, dhe WhatsApp **[A.I103]**. Studentët dhe stafi akademik kanë emrin e përdoruesit dhe emailin e tyre që ofrohen nga institucioni për t'i përditësuar me informacione. Ata përdorin platformën Google Education si formë komunikimi **[BM2, A.I100, dhe A.I104]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se institucioni nuk ka një sistem të qendëruar informacioni për shkak të numrit të vogël të stafit dhe studentëve. AI-ja e menaxhon procesin me platforma të tjera ose përmes kontakteve të drejtpërdrejta **[Kapitulli III Standardi VII.1]**.
- 2.10 Institucioni e ka zgjeruar infrastrukturën e tij me 2 objekte të reja **[BM8, A.I101, A.I102]**. Në të gjitha godinat ofrohen lidhje me internetin. Të gjithë auditorët dhe katër laboratorët kryesorë janë të pajisur me kompjuterë, videoprojektorë, ekranë dhe tabela, ku pedagogët mund të përdorin çfarëdolloj teknike mësimdhënieje **(A.I 37 – A.I37.2)**. Studentët kanë akses në bibliotekën elektronike me emrin “Research4Life” **[RVV, BM8, A.I102, A.I106]**. Për përdorimin efikas të teknologjive të mësimdhënies, stafi ka përgatitur disa video udhëzuese dhe prezantuese për studentët **[A.I76, A.I77]**. **[Kapitulli III Standardi VII.2]**.
- 2.11 Akademia “Ivodont” ndodhet në 3 godina me 15 metra distancë nga njëra - tjetra. Ka 10 laboratorë dentarë që iu kushtohen grupeve të ndryshme lëndore dhe janë të pajisur me hapësira pune profesionale për teknikët dentarë **[A.I101, A.I102, A.I106]**. Pajisjet, mjetet dhe aparaturat që përdoren në mësimdhënie dhe kërkim përmbushin kërkesat më të fundit për studimin e rrjedhës digjitale të punës në laboratorë dentarë, si dhe sjelljen e materialeve dentare **[A.I 37-A.I37.2, BM8]**. Këto pajisje të kushtueshme janë dhënë pjesërisht në formën e një “huaje për përdorim” nga prodhues të mirënjohur, si Ivoclar Vivadent AG or Netzsch GB **[BM3]**. Sipas Marrëveshjes me një klinikë dentare të brendshme, Akademia “Ivodont” ka pasuruar mundësitë dhe cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve **[A.I66]**. Siguria dhe sigurimi menaxhohen përmes një sistemi zjarrfikës, një sistemi alarmi, një sistemi qendror audio, si dhe shoqërive të kontraktuara të sigurisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e pohon ndërmarrjen e këtyre hapave në zhvillimin e infrastrukturës dhe logjistikës për studentët dhe stafin akademik. **[Kapitulli III Standardi VII.3]**.

- 2.12 Të dhënat akademike, kulturore dhe shkencore ruhen elektronikisht në arkivën e menaxhuar nga Protokollin. **[RVV, A.197]** Institucioni i ruan edhe kurrikulat, planet mësimore, botimet, mediat, punimet e stafit dhe studentëve në format elektronik dhe të shtypur në biblioteka. Në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit akademik, AI-ja iu ka ofruar studentëve dhe stafit një bibliotekë fizike dhe online, e cila mundëson një shumëllojshmëri titujsh. **[BM2, A.1104]** Në këtë drejtim mbetet ende progres për t'u bërë. **[Kapitulli III Standardi VII.4].**
- 2.13 Infrastruktura e Akademisë "Ivodont" ofron kushte të përshtatshme dhe moderne për realizimin e veprimtarive të përditshme akademike dhe administrative. Numri i godinave është i mjaftueshëm në raport me numrin e stafit dhe studentëve për të zhvilluar veprimtaritë shkencore dhe mësimore. Godinat janë gjithnjë në ndryshim për t'u përshtatur me zhvillimet më të fundit teknologjike në teknika dentare dhe numrin e stafit dhe studentëve. Krahas kësaj, ato përmbushin edhe standardet fizike dhe kimike të parashikuara nga Shtetit, si dhe mundësojnë kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët, si konferenca me organizata të tjera. **[RVV, BM8, A.1101, A.1102]** **[Kapitulli III Standardi VII.5, VII.6]**
- 2.14 AI-ja ka katër godina me infrastrukturën e nevojshme për të kryer veprimtaritë e institucionit dhe për të përmbushur standardet e higjienës, ndriçimit, zhurmës, temperaturës, lagështisë dhe hapësirës. **[BM8]**. Krahas kësaj, ato ndodhen në zona pa ndotje dhe zhvillim industrial **[BM8; A.1101]**. Godinat mund të aksesohen edhe nga personat me aftësi të kufizuara përmes rampave **[BM8, RVV]**. AI-ja ka edhe hapësira të jashtme sportive, kafene, dhe një zonë të vogël rekreative. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me organizata të tjera për ofrimin e mundësive sportive, si: hapësirat dhe klubet e sportit **[RVV]**. Përgjithësisht, auditorët, klasat dhe laboratorët i përmbushin kërkesat për mundësimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo vetëm. **[A.1101, A.1102]. [Kapitulli III Standardi V.1].**
- 2.15 Zyra e Protokollit dhe Arkivës ruan të gjithë dokumentacionin në format të shtypur, sipas Rregullores për Arkivën-Protokollin **[BM8; A.1197]**. Sekretaria Mësimore në AI është përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave rreth regjistrimit të studentëve, numrit të regjistrimit, etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, si dhe rregulloret e zyrës **[A.117; A.197]. [Kapitulli III Standardi V.2].**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoji karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Institucioni ka laboratorë dhe infrastrukturë të dedikuar për teknikat dentare, që iu mundësojnë studentëve formim të mirë profesional **[Kapitulli III Standardi VII.3].**
- AI-ja zbaton një politikë të hapur burimesh njerëzore për punësimin dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar akademik dhe administrativ **[Kapitulli III Standardi IV.1].**

- Digjitalizimi i teknikave dentare që përdoren në mësimdhënie dhe laboratorë kërkimorë.
- AI-ja ka krijuar bashkëpunim të mirë me laboratorët dentarë privatë në Shqipëri dhe Gjermani (alumni të suksesshëm të AI-së) për të mbështetur studentët gjatë formimit të tyre praktik, çka është kyç për punësimin e tyre në të ardhmen **[Kapitulli III Standardi III.3]**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon hapat që po ndërmerren për të përdorur teknologjinë e mësimin në distancë gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 **[Kapitulli III, Standardi VII.1]**

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Akademia "Ivodent" zbaton politika të qarta në lidhje me informacionet rreth programeve mësimore që ofron **[A.I109; A.I110; A.I120]**. Përgjegjësit e departamenteve, në bashkëpunim me anëtarët e stafit akademik dhe mbështetës, si dhe me zyrën e shërbimit të studentëve, zhvillojnë takime informuese me nxënësit e shkollave të mesme rreth ofertës akademike të AI-së jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shkollat shqipe të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut **[A.I112; A.I113, BM3]**. Stafi akademik është pjesë e kësaj veprimtarie vjetore. Për shkak të situatës së COVID-19, AI-ja ka organizuar takime dhe prezantime online për të informuar kandidatët dhe palët e treta rreth programeve të ofruara. Këto veprimtari kryhen në përputhje me drejtoritë e shkollave të mesme, si dhe me mësuesit dhe stafin e caktuar administrativ. Institucioni organizon edhe Ditë të Hapura dhe merr pjesë në panairë të ndryshme Pune dhe Studimi, gjatë të cilave i fton të diplomuarit dhe nxënësit në mjediset e Akademisë për t'u njohur me programet e studimit, stafin akademik, dhe infrastrukturën në mbështetje të mësimdhënies ose mundësitë që jepen nga tregu i punës. **[A.I59; A.I112, BM3]** Informimi i studentëve është një proces që zhvillohet gjatë të gjithë vitit akademik. **[A.I92; A.I92.1; A.I92.2; A.I114, BM3, BM2]**. Veprimtaria e Akademisë "Ivodent" mbështetet në misionin e parashikuar në Statut dhe Strategjinë e Zhvillimit 2018-2023 **[A.I8; A.I12]**. Puna bazohet në procesin mësimor, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë studentëve, vlerësimit dhe mbështetjes së stafit akademik, promovimit të barazisë, si dhe çmuarjes së diversitetit. AI-ja ka përcaktuar qartë në Statutin dhe Rregulloret e saj kriteret për pranimin e studentëve **[A.I17; A.I39; A.I39.1; A.I39.2; A.I39.3, BM1]**. Pranimi i studentëve bëhet sipas dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi, në përputhje me standardet shtetërore, dhe kapacitetet akademike dhe infrastrukurore **[A.I25; A.I25.1; A.I25.2, BM5]**. Prioritetet e programeve shprehen në Strategjinë e Institucionit 2018-2023 **[A.I12]**. Në përputhje me misionin e tij, institucioni ofron tri programe, përkatësisht një program profesional 2-vjeçar, një Bachelor të ciklit të parë, dhe një Master Profesional njëvjeçar, si dhe ka plane afatshkurtra për të ofruar programe të mëtejshme të ciklit të dytë dhe të tretë **[A.I109; A.I110; A.I120; A.I12; A.I87, BM4]**. Programet e studimit organizohen me kohë të plotë dhe në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, dhe praktikat më të mira evropiane **[A.I116; A.I121]**. Ato përkojnë krejtësisht me misionin e AI-së dhe i pasqyrojnë të gjitha kërkesat e parashikuara në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar. **[A.I56]**. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë është i mundur për çdo kandidat, që e ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të lartë dhe përmbush kriteret e notës mesatare, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. **[A.I39; A.I39.1; A.I39.2; A.I39.3, BM1, BM4, BM5]**. Kriteret e pranimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programet e ciklit të parë kanë si kriter shtesë edhe notën mesatare prej 6.5. Studentët regjistrohen në Zyrën e Sekretarisë. **[A.I108]**. Të dhënat e regjistrimit dhe numri i matrikullimit ruhen në Regjistrin Themeltar në format të shtypur dhe elektronik. Të dhënat e studentëve skedohen dhe ruhen në format elektronik dhe të shtypur, si dhe menaxhohen nga sekretaria **[A.I108]**. Procesi i regjistrimit përfshin gjithashtu nënshkrimin e një kontrate midis institucionit dhe studentit **[BM5]**. Programet përmirësohen vazhdimisht për të arritur

objektivat e parashikuara në Strategjinë e institucionit, dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të punës **[A.I12; A.I56, BM3, BM6]** *[Kapitulli I, Standardi I.1]*.

3.2 AI-ja punon drejt programeve të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përmbushjes së prioriteteve dhe kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015, Neni 81. Aktualisht, AI-ja ofron 3 programe studimi me kohë të plotë **[A.I109; A.I110; A.I120; A.I121]**. Programet e studimit janë ideuar në mënyrë të tillë që iu ofrojnë studentëve kulturën dhe njohuritë e nevojshme dhe të mjaftueshme për mundësinë e të nxënit të pavarur gjatë gjithë jetës. Ato zhvillohen duke marrë parasysh logjikën e kombinimit dhe integritit të njohurive dhe praktikës në auditorë, si një aspekt i përgatitjes akademike të studentëve me vijimësi pas diplomimit, me qëllim ndryshimin e përmbajtjes së programeve dhe syllabuseve përkatëse. Institucioni organizon trajnime dhe aktivitete që iu mundësojnë studentëve dhe profesionistëve, të cilët marrin pjesë për t'u certifikuar dhe për t'u vlerësuar me kredite **[A.I75]**. Akademia ofron programe kualifikimi që miratohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë), që njihen jo vetëm në tregun shqiptar të punës, por edhe më tej. **[A.I124; A.I125; A.I126]** Institucioni ruan kontakte me alumnit, me qëllim që t'u japë mundësinë të marrin pjesë në trajnime, etj., si dhe t'u marrë mendimet për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të ofruara. **[BM6]**. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sekretaria e Shërbimeve dhe Departamentet vlerësojnë përvojën e përvetësuar nga projektet kërkimore, konferencat dhe trajnimet, të cilën e pasqyrojnë në përmbajtjen e kurrikulave gjatë përmirësimeve periodike **[A.I38; BM5]**. Deri tani, vetëm programi Bachelor ka pasur ndryshime, me hapjen e dy programeve të reja. **[A.I120]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon institucionit që të hapë programe të reja të Masterit Shkencor, në përputhje me strategjinë dhe profilin e tij *[Kapitulli I, Standardi I.2]*.

3.3 Programet e studimit që ofrohen në Akademinë "Ivodont" janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional **[A.I12]**. Në këtë kontekst, programet e studimit përshtaten dhe realizohen paralelisht me strategjinë e zhvillimit të AI-së, me qëllim formimin dhe përgatitjen e studentëve në përputhje me prirjet e tregut të punës dhe në shërbim të zhvillimeve dinamike **[A.I56, BM4; BM6]**. Gjatë periudhës 2020 - 2021 u hapën dy programe të reja studimi, përkatësisht programi i Masterit Profesional në "Teknika Digjitale Dentare" dhe programi Profesional në "Teknika Dentare" **[A.I115]** *[Kapitulli I, Standardi I.3]*.

3.4 Programet e studimit dhe trajnimet kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2018-2023 **[A.I12]**. Këto objektiva pasqyrojnë zhvillimet kombëtare ekonomike dhe teknologjike. Programi Bachelor në "Teknika të Larta Dentare" u riorganizua në vitin 2021, mbështetur në kërkesat e tregut për teknikë dentarë **[A.I115]** *[Kapitulli I, Standardi I.4]*.

3.5 Bazuar në numrin e studentëve të regjistruar, Ligjin Nr. 80/2015, kapacitetet njerëzore, infrastrukturë dhe logjistike, AI-ja i kërkoi MAS-it statusin e një institucioni të veçantë që mund t'i zbatojë programet e studimit në mënyrë optimale, në përputhje me kërkesat

ligjore, si dhe me fleksibilitet sa i përket stafit akademik **[A.19]**. Për vitin akademik 2020 - 2021, Akademia ka angazhuar 14 pjesëtarë të stafit akademik, 9 prej të cilëve punojnë me kohë të plotë, ndërsa 5 me kohë të pjesshme **[A.125; A.188; A.188.1; A.188.2, BM3]**. Si një institucion që ofron programe studimit vetëm në një fushë, në atë të teknikave dentare, shpërndarja e ngarkesës mësimore është relativisht e thjeshtë. Ngarkesa mësimore i shpërndahet stafit akademik të departamenteve duke marrë mendimin e tyre paraprakisht, si dhe duke u mbështetur te kuadri ligjor, formati i lëndës/modulit, kualifikimet dhe përvoja në mësimdhënie **[A.1109; A.1110; A.1120, BM3, BM4]**. Përveç mësimdhënies, stafi akademik përmbush detyrimet akademike që parashikohen në Udhëzimin Nr. 29/2018, duke u angazhuar në veprimtari kërkimore, botime shkencore, dhe aktivitete akademike **[I.80]**. **[Kapitulli I, Standardi I.5]**.

3.6 Programet e studimit, kurrikula, ngarkesa e krediteve, objektivat e trajnimit, etj., botohen në faqen zyrtare të Akademisë "Ivodont" **[BM5]**. Për këtë arsye, çdo student aktual ose i mundshëm ka mundësinë që të informohet saktë rreth ofertës akademike të Akademisë "Ivodont" (www.ivodent.edu.al & www.ivodent.org). Krahas kësaj, gjatë periudhës së aplikimit dhe regjistrimit, stafi dhe asistentët akademikë i këshillojnë dhe i udhëzojnë studentët rreth programit të studimit dhe hollësive të tjera në lidhje me akademinë **[BM3, BM5]**. Programet e studimit kanë objektiva të qarta, në përputhje me qëllimet e caktuara nga Institucioni në Planin e tij të Zhvillimit Strategjik 2018-2023 **[A.112; BM4]**. Një ndër objektivat kryesore përfshin përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e teknikave dentare, duke i informuar rreth teorisë dhe praktikës së teknikave, instrumenteve dhe metodave më bashkëkohore (sasiore dhe cilësore), përmes të cilave ofrohen zgjidhje për probleme të ndryshme të prostetikës dentare me të cilat do të përballen kur të fillojnë punë. Një tjetër objektiv është dhënia e njohurive të nevojshme dhe kualifikimeve të mëtejshme në programet e ciklit të dytë **[BM3; BM4; BM6]**. Kriteret e pranimit përcaktohen çdo vit nga Senati Akademik **[A.139 to A.139.3]**. Kriteret, dokumentet dhe procedurat e aplikimit botohen në faqen zyrtare të akademisë (www.ivodent.edu.al) dhe në media sociale **[A.1103]**. Sekretaria Mësimore dhe Shërbimeve ndaj Studentit ofron informacione ballë për ballë ose në rrugë elektronike. Studentët informohen rreth programeve nga pedagogët gjatë javëve të para të kurseve të tyre **[BM2, BM3]** **[Kapitulli I, Standardi I.6]**.

3.7 Programet e studimit mundësojnë kalimin nga cikli i parë në ciklin e dytë të studimeve, duke garantuar koherencë dhe vazhdimësi në përmbajtje. Mbështetur në dosjen e programeve të studimit **[A.1109; A.1110; A.1121; A.1122]**, objektivat e tyre përfshijnë pajisjen e studentëve me njohuri dhe koncepte bazë, aftësi analitike, krijuese, vendimmarrëse dhe profesionale, sipas metodave shkencore dhe të përgjithshme. Përfundimi i suksesshëm i ciklit të parë mundëson pranimin në ciklin e dytë ose në tregun e punës. Studentët informohen dhe orientohen rreth mundësisë së transferimit të studimeve të tyre në programe të ngjashme në përputhje me aktet ligjore të Ministrisë së Arsimit **[A.1114; BM2; BM5]**. Studentët informohen rreth vazhdimësisë së studimeve nga programet e ciklit të parë në atë të dytë. Takimet me alumnit dhe studentët ishin shembuj të këtij informimi **[BM2, BM6]**. Programet e studimit rishikohen dhe përmirësohen

vazhdimisht në përputhje me kërkesat e tregut të punës **[A.I120, BM3, dhe BM4]**. Në fund të ciklit të parë të studimeve, shumica e studentëve kanë mundësi punësimi **[A.I68; A.I69, BM6]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon orientimin e institucionit drejt hapjes së programeve të reja të studimit, veçanërisht programeve të studimit të nivelit të dytë/programeve të Masterit. **[Kapitulli I, Standardi I.7].**

3.8 Studentëve iu ofrohet mbështetje dhe këshillim karriere nga Sekretaria **[A.I108, BM2]**. Në bashkëpunim me departamentet, Sekretaria i informon studentët dhe i nxit që të bëhen pjesë e trajnimeve, stazheve dhe bursave, i mbështet në formimin e tyre profesional gjatë jetës, si dhe i këshillon rreth aplikimit për shkolla verore, trajnime, vende pune, etj. **[A.I108; A.I112; BM2]**. Stafi akademik orientohet drejt mësimdhënies dhe/ose kërkimit. **[A.I88; BM3]**. Marrëdhëniet e punës së stafit akademik në AI rregullohet me kontrata pune individuale, në zbatim të Kodit të Punës dhe Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë **[II.2; II.2.1]**. Në përputhje me legjislacionin dhe në zbatim të marrëveshjes me MAS-in, akademia është siguruar që mbi 70% e ngarkesës mësimore në programet e studimit të mbahet nga stafi akademik me kohë të plotë **[A.I9, BM1]**. Edhe nga vlerësimet e kryera nga inspektorët e MAS-it doli që AI-ja e përmbush këtë kriter në normën 71% **[A.I25 to A.I25.2] [Kapitulli I, Standardi I.8].**

3.9 Akademia nuk ofron programe në fushën ekonomike, por bashkëpunon ngushtësisht me aktorët e tregut të punës për të konsoliduar profilin e studentëve të diplomuar me njohuri ekonomike dhe biznesi, duke qenë se shumica e studentëve hapin laboratorët e tyre privatë. Në këtë drejtim, partnerët e AI-së japin ndihmë në veçantë gjatë praktikave profesionale që studentët kryejnë në mjediset e tyre **[BM6] [Kapitulli I, Standardi I.9].**

3.10 Programet e studimit që ofrohen nga AI-ja janë në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës dhe nivelet 5, 6 dhe 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve **[A.I109; A.I110; A.I120]**. Informacionet rreth institucionit janë të disponueshme edhe në gjuhën angleze, në format të shtypur dhe elektronik **[BM5]**. Studentët e diplomuar pajisen me diplomë dhe suplementin përkatës, që përmban informacione të dobishme rreth numrit të kurseve, vlerësimit dhe krediteve përkatëse në shqip dhe anglisht **[A.I123]**. Ky informacion lehtëson procesin e njohjes, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve. Studentët e diplomuar që punojnë jashtë vendit e kanë pasur të mundur njohjen e programit në Gjermani, çka tregon se përmbajtja dhe organizimi i tij i plotëson kërkesat e institucioneve ndërkombëtare dhe iu mundëson studentëve transferimin e njohurive **[A.I 126; A.I128]. [Kapitulli 1, Standardi I.10].**

3.11 Programet e studimit janë hartuar dhe janë rishikuar në mënyrë që të mundësohej harmonizimi me programet brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve **[A.I115; A.I117; A.I120]**. Programet e studimit që ofrohen nga AI-ja janë kombinim i njohurive teorike dhe praktike, duke iu mundësuar studentëve që të vënë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e përvetësuara në modulet teorike, si dhe duke qenë të udhëzuara nga kompetencat e përftuara nga studentët në çdo program studimi **[A.I118; A.I119; BM3; BM4]**. Aktualisht zbatohet sistemi i vlerësimit me Kredite

Evropiane **[A.I123; RVV]**. AI-ja mbështet dhe promovon pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari jashtëkurrikulare, si: leksione të hapura, klube studentore, konferenca studentore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe workshop-e, që iu japin mundësinë të vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë e fituara. **[A.I83; BM2] [Kapitulli I, Standardi I.11]**.

3.12 Programet e studimit janë shpërndarë normalisht gjatë aktiviteteve akademike, sipas parashikimeve të VKM-së 41.2015. **[A.I88; A.I88.1; A.I88.2; BM3]**. Njohurit teorike dhe praktike vihen në zbatim nga studentët në laboratorë dentarë, mbështetur në kompetencat e përvetësuar në çdo program studimi **[A.I109; A.I110; A.I120]**. Si forma, ashtu edhe përmbajtja e programeve të studimit përgatiten në mënyrë të tillë që t'iu japin studentëve njohuri praktike. Programet e studimit hartohen sipas nivelit dhe fushës specifike të studimit. Stazhet ofrojnë mundësi shtesë për zhvillimin e aftësive për punësim dhe krijimin e kontakteve të dobishme **[A.I124; A.I 127; BM2; BM6]**. Në fund të ciklit të studimeve janë të punësuar 100% e studentëve **[A.I68; A.I69]**. Marrëveshjet e nënshkruara midis AI-së, Institucioneve të Arsimit të Lartë **[A.I62; A.I63; A.I64; A.I13; A.I14]** dhe laboratorëve privatë dentarë **[A.I67; A.I66; A.I71; A.I15; A.I57]** ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale, që parashikohen në programe dhe kanë ndikim pozitiv në rritjen e punësueshmërisë **[A.I60; BM6]**. Infrastruktura laboratorike e AI-së është moderne dhe mundëson arsimimin e studentëve me teknika të përditësuar dhe të avancuara të prostodontikës dentare **[A.I101; A.I106]**. Krahas kësaj, numri i ulët i studentëve që pranohen çdo vit në akademik ndihmon në përgatitjen e tyre profesionale përmes punës së diferencuar dhe individuale. **[Kapitulli I, Standardi I.12]**.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Programet e studimit në AI orientohen për nga praktika, dhe përditësohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës për specialistët në teknika dentare **[Kapitulli I Standardi I.10, Kapitulli I Standardi I.9, Kapitulli I Standardi I.12]**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon institucionit që të hapë programe të reja të Masterit Shkencor, në përputhje me strategjinë dhe profilin e tij **[Kapitulli I, Standardi I.2]**.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon përpjekjet që po bëhen për të përmbushur kërkesat e tregut për teknikë dentare digjitale, duke hapur një program të ri Masteri Profesional në Teknika Dentare Digjitale **[Kapitulli 1, Standardi 1.3]**.
- Diploma e Bachelorit në “Teknika të Larta Dentare” e Akademisë “Ivodont” u njoh zyrtarisht në Gjermani, në dhjetor 2021 **[Kapitulli 1, Standardi 1.10]**.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 AI-ja përqendrohet te përmirësimet e përhershme të laboratorëve, pajisjeve dhe mjeteve dentare që përdoren në trajnime praktike dhe profesionale **[A.I.101]**. Orët praktike realizohen me maksimumi 15 studentë, të cilët mund të përdorin laboratorët nën mbikëqyrjen e asistentëve deri në orët e mbrëmjes **[BM2; BM3]**. Në këtë mënyrë, studentët njihen me teknikat moderne të teknologjisë dentare, duke përfshirë rrjedhën digjitale të punës në prodhimin e protezave dentare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i pa pajisjet dhe mjetet e mëposhtme të rëndësishme, të cilat janë dhënë në formën e një “huaje për përdorim” nga partnerët mbështetës të AI-së: tre laboratorë me 20 hapësira moderne pune për teknikë dentarë, të pajisur me njësi ndriçuese, aspiratorë, mikro-motorë, set qeramike, set furçash, set prerësish/gominash nga prodhues të mirënjohur, një laborator me rrjedhë digjitale pune me 20 hapësira pune, i pajisur me kompjuterë dhe software të Sistemit Dentar të Formave 3D për projektimin e kurorave, urave, implanteve, splinteve dentare, proteza të pjesshme dhe të plota që gjenerohen me CAD/CAM digjital, për analizën e njëkohshme të ndryshimeve në qeramikë gjatë nxehjes në 1600°C. **[BM8, Tur në mjedise]**. AI-ja e administron praktikën profesionale të studentëve në laboratorë dentarë privatë në Shqipëri dhe Gjermani në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara, duke përfshirë një plan mësimor që mbikëqyret periodikisht nga stafi akademik. Të gjithë studentët konfirmuan se janë të kënaqur me praktikën **[BM3]**. Për sa i përket përgatitjes për provimin përfundimtar, gjatë punës praktike në laborator, studentët mbikëqyren dhe mbështeten nga udhëheqësit e caktuar **[RVV, fq. 51; BM3; BM4]**. Biblioteka ka një numër të kufizuar titujsh shkencorë dhe studentët kanë akses në bibliotekën online R4L **[RVV, fq. 51; BM3; BM4]**. *[Kapitulli I Standardi II.1]*.
- 4.2 Të gjithë studentët në të tria programet e studimit në AI duhet të plotësojnë detyrimet e parashikuara në rregulloret përkatëse, në mënyrë që të diplomohen me sukses **[A.I.108; A.I.109; A.I.110]**. Gjatë dy viteve të fundit, studentët i kanë kryer orët e programit praktikë në praninë e tyre fizike pas periudhës së izolimit **[BM2]**. Të gjithë studentët, që i kanë përfunduar me sukses studimet e tyre në programin Bachelor në “Teknika të Larta Dentare”, marrin diplomën përkatëse të pararegjistruar në regjistrin e diplomave dhe certifikatave në MEST **[A.I.130]**. *[Kapitulli I Standardi II.2]*.
- 4.3 Programi Bachelor në “Teknika të Larta Dentare” ishte i vetmi program studimi në AI gjatë periudhës 2010 - 2020 dhe ka ndryshuar njëherë nën 20% gjatë vitit 2018 dhe deri në 60% gjatë vitit aktual akademik 2021 - 2022 **[A.I.132]**. Në vitet 2020 dhe 2021 u hapën dy programe të tjera në AI. Fokusi kryesor i këtyre ndryshimeve ka qenë bashkërendimi i aftësive të përvetësuara nga nxënësit me ndryshimet e kërkesave të tregut të punës për teknikë dentarë **[RVV fq. 53]**. Procesi i ndryshimeve në program realizohet duke marrë parasysh kërkesën e studentëve dhe alumnive për më shumë orë praktike **[RVV fq.54; BM3]**. Për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, UCB-ja ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Komisionin e Sigurimit të Cilësisë (KSC) **[A.I.18]**. Funkionimi dhe kompetencat e NJSBC-së janë parashikuar në Statutin **[A.I.8]** dhe rregulloret përkatëse të AI-së **[A.I.38]**.

Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit, pedagogëve, etj., kryhen në fund të çdo viti akademik në formën e një analize SWOT, duke përfshirë edhe masat për përmirësim **[A.I.24]**. AI-ja përfshin në vlerësimin e cilësisë së programeve edhe përqindjen e punësimit të të diplomuarve **[Kapitulli I Standardi II.3]**.

4.4 Strukturat e AI-së që janë përgjegjëse për përmirësimin e procesit mësimor janë departamentet, të cilat marrin ndihmë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sekretaria Mësimore për të treguar cilësinë e mësimdhënies **[A.I.17; A.I.38]**. Pyetësi i studentit organizohet dy herë në vit, duke përfshirë edhe periudhën e pandemisë kur u krye nga një institucion mbështetës jashtë AI-së **[A.I.24]**. Instrumentet për ofrimin e mësimin në distancë u zhvilluan me sukses dhe u përdorën nga pedagogët sipas nevojës **[A.I.76; A.I.77]**. Sikundër përmendet më sipër, vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të anketës së studentit, të cilat orientojnë hapat e mëtejshëm të departamenteve për t'u përmirësuar. Krahas kësaj, AI-ja ka mbështetur përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet organizimit të trajnimeve gjatë periudhës së leksioneve online **[BM3]**. Gjithashtu, deklarohet se cilësia e mësimdhënies arrihet përmes trajnimit për përdorimin e platformës online dhe mundësimin të infrastrukturës së nevojshme **[RVV, fq. 55]**, por lista e pjesëmarrësve dhe tema e trajnimit mungon. AI-ja fton një numër të konsiderueshëm lektorësh dhe trajnerësh të huaj, të cilët kontribuojnë në përmirësimin e teknikave të mësimdhënies. Infrastruktura e mësimdhënies në AI është moderne dhe funksionale **[BM8]**. **[Kapitulli I Standardi II.4]**.

4.5 Departamenti është njësi bazë mësimdhënieje dhe kërkimi mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe rregulloret e brendshme institucionale. Për shkak të numrit të kufizuar të stafit akademik, departamentet e AI-së nuk ndahen në grupe mësimdhënëse-kërkimore **[A.I.19; A.I.81]**, por punojnë bashkërisht në këto dy fusha në Fakultet dhe ndajnë të njëjtin buxhet kërkimor. Në Nenin 80 të Statutit të AI-së parashikohet qartë se AI-ja mundëson krijimin e një mjedisi që promovon liri dhe autonomi akademike **[BM3; BM4]**. AI-ja e mbështet stafin e saj financiarisht në pjesëmarrjen në konferenca ose botime. Megjithatë, vetëm në vitin 2022, AI-ja do të shpërndajë fondin e kërkimit prej 5-10% në mënyrë transparente sipas Urdhrit të Dekanit të Fakultetit të Teknikave Dentare për "Procedurat e vlerësimit, financimit dhe raportimit të propozimeve kërkimore" **[BM3]**. Një praktikë e mirë për përmirësimin e infrastrukturës kërkimore është bashkëpunimi me prodhuesit e pajisjeve për analizimin dhe përpunimin e materialeve të tyre dhe përfaqësuesit e tyre, nëpërmjet të cilëve departamentet morën pajisje të kushtueshme për kërkim në formën e "huas për përdorim" **[BM3; BM4; BM8]**. Pajisje të tilla, si: STA për analizë termike të materialeve (prodhuesi: NETZSCH GmbH) ose CAM PM7 (prodhuesi: Ivoclar Vivadent AG), kushtojnë rreth 150.000 euro dhe nuk mund të përballohen nga një institucion i vogël si AI-ja **[BM4]**. Këto pajisje janë në dispozicion të stafit kërkimor të AI-së, por përbëjnë edhe një mundësi që AI-ja t'i ofrojë hapësira kërkimi studiuesve nga institucione të reja, duke qenë se nuk janë të disponueshme në institute të tjera kërkimore në rajon **[Kapitulli II Standardi I.1]**.

4.6 Për të mbështetur stafin akademik në kërkim, AI-ja ka ngritur Komisionin e mbështetjes së Kërkim-Zhvillimit **[A.I.18; BM4]**. Fondi i kërkimit i planifikuar në buxhetin e vitit 2022 është në nivelin 5-10% dhe do të qeveriset nga komisioni. Fondi do të shpërndahet sipas urdhrat të Dekanit të Fakultetit të Teknikave Dentare për procedurat e vlerësimit, financimit dhe monitorimit të propozimeve/projekteve kërkimore **[RVV fq. 57; BM4]**. Nuk ka një procedurë të qartë për shpërndarjen e fondit të kërkimit, kryesisht për shkak të numrit të vogël të stafit akademik, çka do të thotë që kryhet sipas vendimit të Dekanit. Por tani institucioni ka hapur dy programe të tjera studimi dhe planifikon të zgjerojë më tej infrastrukturën e tij, çka do të thotë se nevojitet një procedurë e qartë për shpërndarjen e fondeve të kërkimit. Megjithatë është një institucion i vogël me staf të kufizuar dhe vetëm një program Bachelor gjatë vitit akademik 2021 - 2022, AI-ja i nxit përpjekjet për zhvillimin e kërkimeve **[Kapitulli II Standardi I.2]**.

4.7 AI-ja përqendrohet te rritja e përhershme e numrit të bashkëpunëtorëve ndërkombëtarë në kërkimet e aplikuara ndër institucionet kërkimore dhe departamentet e K&ZH të prodhuesve dentarë. Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm duke organizuar disa workshop-e rreth teknikave dentare dhe karakterizim të materialeve, me pjesëmarrjen e studiuesve nga institucione dhe shoqëri partnere **[A.I.73; A.I.83; A.I.84]**. Anëtarët e AI-së janë financuar për rrjetëzim dhe mobilitet kërkimor nga Programi COST në disa raste **[A.I.82]**, ndonëse shifra mbetet e ulët, edhe për shkak të mungesës së marrëveshjeve me universitete të tjera për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit. GVJ-ja i rekomandon institucionit që të nënshkruajë marrëveshje me universitete të tjera jashtë vendit për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit, çka do të rritë ndjeshëm produktin kërkimor të AI-së. Anëtarët e AI-së i botojnë rezultatet e kërkimeve të tyre kryesisht në konferenca ndërkombëtare dhe takime jashtë vendit, në bashkëpunim me studiues të huaj të rrjeteve të konsoliduara **[A.I.80]**. Anëtarët e AI-së kanë shkruar projekt-propozime për financimin e ideve të tyre kërkimore bashkërisht me partnerët e tyre institucionalë në thirrje të programeve ndërkombëtare dhe kombëtare **[RVV fq. 57-58]**. Aplikimet nuk janë financuar deri tani, por përpjekjet e AI-së janë inkurajuese **[Kapitulli II Standardi I.3]**.

4.8 AI-ja i identifikon fushat e kërkimit shkencor sipas prirjeve të zhvillimeve ndërkombëtare në degën e teknologjisë dentare në universitetet e shkencave të zbatuara dhe në departamentet e kërkimit dhe zhvillimit të prodhuesve të fushës. Prioritet ka ndërkombëtarizimi i kërkimit duke marrë pjesë në programe evropiane rrjetëzimit, si COST, si dhe në drejtime kërkimore që sjellin produkte novatore **[RVV fq. 59]**. Komisioni i Përhershëm i Mbështetjes së Kërkim-Zhvillimit kontribuon në kërkime shkencore **[BM4]**. AI-ja është organi aderues në Shoqatën e Kristalografëve Shqiptarë (www.aac-cryst.eu) me rrjetëzim të mirë si anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Kristalografëve, që organizon veprimtari të përbashkëta shkencore të cilat ndihmojnë me bashkërendimin e kërkimit me prirjet ndërkombëtare **[BM6]**. **[Kapitulli II Standardi I.4]**.

4.9 AI-ja zbaton një strategji kërkimi që përqendrohet te studimi i materialeve dentare dhe e mbështet duke ofruar mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e kërkimeve

[A.I.12; BM4; BM8]. Botimet më të fundit të stafit akademik janë në përputhje me këtë strategji të mirëspecifikuar dhe përfshijnë anëtarë të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të AI-së **[A.I.80; BM6]**. **[Kapitulli II Standardi I.5]**.

4.10 Në planin strategjik të AI-së kërkimi shkencor parashikohet si një nga elementet e rëndësishme për funksionimin e veprimtarisë institucionale **[A.I.12]**. Për këtë arsye, gjatë vitit akademik i gjithë stafi angazhohet me punë kërkimore. AI-ja fton personel akademik vendas dhe të huaj që të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe angazhime me kohë të pjesshme **[A.I.73]**. **[Kapitulli II Standardi I.6]**.

4.11 AI-ja e mbështet stafin e saj akademik në botimin e rezultateve kërkimore në konferenca dhe buletine, disa prej të cilave kanë ndikim pozitiv **[A.I.42]**. Në sajë të numrit të vogël të stafit akademik (vetëm 9 punonjës me kohë të plotë), AI-ja nuk ka zhvilluar ende një konferencë shkencore në lidhje me temat e teknologjisë dentare **[Kapitulli II Standardi I.7]**.

4.12 AI-ja synon të krijojë markën e vet dhe më pas të marrë patentat sipas zhvillimit të produkteve së brendshmi dhe në bashkëpunim me partnerët e saj **[A.I.65]**. Puna kërkimore dhe botimet janë në fushën e materialeve dentare, gjejnë zbatim në shëndetin dentar, si dhe janë në përputhje me strategjinë e AI-së për kërkim **[BM4]**. Në mbledhjen me Bordin e Administrimit u përmend vendimi i tij për buxhetin e kërkimit, që në vitin 2022 pritet të jetë 5-10% **[BM4]**. **[Kapitulli II Standardi I.8]**.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se institucioni ka infrastrukturë laboratorike bashkëkohore me pajisje moderne dhe hapësira pune për praktikë dhe kërkime **[Kapitulli I Standardi II.1]**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Mungesa e konferencave shkencore që organizohen në AI rreth temave të teknikave dentare **[Kapitulli II Standardi I.2]**.
- Mungesa e marrëveshjeve me universitete të tjera për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit **[Kapitulli II Standardi I.3]**.
- Mungesa e procedurave të qarta dhe të hollësishme për shpërndarjen e fondeve të kërkimit **[Kapitulli II Standardi I.2]**.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Institucioni duhet të shtojë aktivitetet e stafit akademik dhe studentëve me pjesëmarrje në projekte dhe kërkime brenda dhe jashtë Shqipërisë **[Kapitulli II Standardi I.2]**.
- Institucioni duhet të nënshkruajë marrëveshje me universitete të tjera për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit **[Kapitulli II Standardi I.3]**.
- Për shkak të zgjerimit të strukturës së tij, institucioni duhet të krijojë një procedurë të qartë dhe të hollësishme për shpërndarjen e fondit të kërkimit **[Kapitulli II Standardi I.2]**.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- AI-ja përfshihet në rrjete ndërkombëtare kërkimi, duke pritur anëtarët e Unionit Ndërkombëtar të Kristalografëve për Shqipërinë dhe Kosovën (Shoqata e Kristalografëve të Shqipërisë), si dhe duke dërguar anëtarët e saj në disa Veprimtari të programit COST **[Kapitulli II Standardi I.3]**.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 AI-ja i përgatit studentët me aftësi profesionale dhe integritet, çka parashtrohet qartësisht në misionin e institucionit **[A.I12]**. Në përmbushje të misionit të saj, AI-ja ka hartuar politika pranimi, që synojnë të rritin cilësinë e pranimit duke tërhequr dhe duke diplomuar një trupë studentore cilësore dhe të shumëllojshme nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit me kurrikula, që plotësojnë nevojat aktuale dhe të brendshme të tregut të punës **[A.I58]**. AI-ja pranon një numër të caktuar studentësh bazuar në kapacitetet hapësinore dhe burimet njerëzore, pranime dhe dokumentacionin e kërkuar **[A.I12]**. Megjithatë, duhet vërejtur se studentët nuk iu nënshtrohen provimeve hyrëse **[BM1]**. Krahas kësaj, përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve ballë për ballë, panaireve, etj., AI-ja bën publike ofertën vjetore për programe të ndryshme. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon ditë të hapura ose ditë orientuese për studentët e rinj pranë mjediseve të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si dhe kuotat për çdo program studimi, krahas kriterëve të pranimit, i paraqiten Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë **[A.1.39 deri në A.I39.2]**, si dhe botohen në faqen e internetit AI-ja mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, me autorizimin e tyre, viziton shkolla të mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit, për t'i informuar maturantët rreth programeve të studimit që ofron AI-ja **[Kapitulli I Standardi III.1]**.

5.2 AI-ja garanton komunikimin më efikas dhe profesional midis institucioneve dhe studentëve nëpërmjet veprimtarive orientuese dhe këshilluese. Studentët janë shumë të kënaqur dhe e vlerësojnë shumë këtë mbështetje dhe mundësi nga AI-ja **[BM2; BM3, BM5]**. Zyra e IT-së iu ofron të gjithë studentëve të regjistruar adresa institucionale emaili **[BM2, BM3; BM5]**. Studentët informohen nga sekretaria mësimore përmes njoftimeve të ndryshme në këndet e mjediseve të institucionit, si dhe përmes emaileve në llogaritë e tyre personale studentore **[BM8]**. Krahas kësaj, për studentët e regjistruar dhe të rinjtë që shprehin interes, AI-ja përdor faqen zyrtare dhe rrjetet sociale si një rrugë të rëndësishme komunikimi **[A.I76; A.I111; A.I112]**. Të gjithë punonjësit dhe studentët e institucionit kanë adresa të brendshme emaili, që ofrohen nga departamenti i IT-së (p.sh. emër.mbiemër@ivodent.edu.al). Institucioni ka përgatitur edhe udhëzimet e nevojshme se si stafi dhe studentët mund të aksesojnë informacionet e nevojshme online. Mbështetur në kërkesat e MASR-së, gjatë regjistrimit studentët plotësojnë dosjen e tyre personale me informacionet e nevojshme, në përputhje me kuadrin ligjor dhe dosjen që ruhen në sekretarinë mësimore **[A.I108]**. Për informacione më të mira, komunikim dhe transparencë në vendimmarrje, studentët ftohen vazhdimisht në mbledhjet e njësisive bazë dhe kryesore **[RVV, fq. 70]**. Krahas kësaj, janë anëtarë të Senatit Akademik, por nuk janë të mirinformuar rreth disa proceseve dhe vendimeve të AI-së **[BM2; BM4]**, prandaj përfshirja e tyre në të ardhmen duhet të jetë më aktive. **[Kapitulli I Standardi III.2]**.

5.3 AI-ja ka ngritur Zyrën e Planifikimit të Karrierës për t'iu mundësuar studentëve orientim dhe këshillim karriere, nën varësinë e Dekanatit. Këshilltari i Karrierës e ndjek nga afër procesin e praktikave profesionale të studentëve. Ai i informon studentët rreth organizimit të seminareve të ndryshme, teknikave të kërkimit të punës, shkrimit të CV-së, si dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake. Ai gjen mundësi punësimi për të gjithë

studentët që do të diplomohen nga programi Bachelor dhe organizon veprimtari, që synojnë të ruajnë marrëdhënien me studentët edhe pas diplomimit të tyre. **[RVV, fq. 65-66; BM5, BM7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se kjo gjë është shumë e rëndësishme për studentët dhe se ata janë të kënaqur me punën e këshilltarit të karrierës. Programet e studimit në AI janë ideuar sipas kritereve të parashikuara në Deklaratën e Bolonjës, duke përfshirë kurset e formimit të përgjithshëm ose teknik profesional, etj. Strukturat janë krijuar sipas këtyre standardeve dhe kritereve ligjore të MASR-së. Këshilltarët akademikë dhe ata të karrierës i mbështetin studentët që të adresojnë nevojat e tyre në të gjitha ciklet e studimit. **[Kapitulli I Standardi III.3].**

5.4 Aktualisht, AI-ja ndodhet në mjedise të marra me qira, dhe nga fillimi ka kërkuar përgatitjen e terrenit dhe mjetet e duhura, si pjesë e politikës mbështetëse për studentët e kategorive të veçanta sociale. Kjo shprehet në aktet më të rëndësishme të institucionit, si: Nenet 57 dhe 58 të Rregullores Bazë. AI-ja ka ndërtuar një rampë në hyrje të godinës. Gjithashtu, ka marrë masa për të ofruar mjedise të përshtatshme hidrosanitare, sidomos për kategoritë e veçanta sociale **[RVV, fq. 67]**. AI-ja i mbështet të gjithë studentët pavarësisht racës, ngjyrës, kombësisë, besimit fetar, etj. Gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, institucioni i mbështeti studentët me konsulta mjekësh në rastet e infektimit të dyshuar, reduktim të tarifave të analizave laboratorike në laboratorët me të cilët bashkëpunon institucioni, shërbime dentare falas për studentët, etj. Krahas kësaj, AI-ja ofron bursa për personat me aftësi ndryshe, personat që kanë pësuar fatkeqësi në familje, fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës, si dhe disa kategori të tjera, si punonjësit e Ministrisë së Brendshme, etj. **[A.178-79.3]**. Institucioni ofron bursa për studentët me notë mesatare të shkollës së mesme mbi 9, duke iu dhënë një ulje prej 10%, si dhe për studentët që vërtetojnë se i kanë prindërit me aftësi të kufizuara, të cilët paguajnë $\frac{2}{3}$ e tarifës së shkollës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon se AI-ja ndjek një politikë mbështetëse për studentët dhe iu kushton vëmendje studentëve me nevoja të veçanta dhe nga kategori të veçanta, duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme dhe bursa. AI-ja iu ka vënë në dispozicion studentëve të institucionit Kartën e Studentit. **[Kapitulli I Standardi III.4].**

5.5 Të gjithë titujt në bibliotekë regjistrohen nga zyra e menaxhimit të bibliotekës, që rregullon, monitoron dhe arkivon çdo të dhënë, informacion ose dokument në lidhje me fondin e përgjithshëm të bibliotekës **[BM8, Tur]**. Biblioteka ende është modeste në numrin dhe titujt e librave, botimeve dhe buletineve shkencore në format të shtypur **[A.1106]**. Stafi akademik depoziton një sërë leksionesh të miratuara paraprakisht, që iu ofrohen studentëve përmes platformës online, emailit ose formave të tjera të komunikimit. Institucioni ofron materiale didaktike për të studiuar dhe për të përmbushur detyrimet e procesit mësimor. Gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, materialet aksesoheshin lehtë nga studentët përmes platformës online që përdor AI-ja. Institucioni është i pajtuar online në Research4Life (*Ardi, Oare, Goali, Hinari, Agora*). **[A.1104]** AI-ja ofron literaturë shumëdisiplinore dhe orët e punës në bibliotekë afishohen në mjediset e institucionit dhe në hyrjen e bibliotekës. Gjatë sezonit të provimeve, biblioteka është e hapur edhe gjatë fundjavës. Orari i bibliotekës është shumë i volitshëm, veçanërisht sepse iu ofron studentëve akses edhe në fundjavë gjatë sezonit të provimeve, çka

vlerësohet shumë nga këta të fundit **[BM2, BM5]**. Biblioteka e AI-së ka 18 hapësira leximi dhe kompjuterë. **[Kapitulli I Standardi III.5]**.

5.6 Sekretaria Mësimore dhe Shërbimeve ndaj Studentit i udhëzon dhe i mbështet studentët gjatë procesit të mësimnxënies, çka rregullohet në rregulloren bazë për studime, si dhe në Nenin 6 të rregullores për studimet dhe provimet universitare. Literatura e nevojshme për kurset e ofruara bëhet e njohur përmes syllabusit në fillim të semestrit. Pedagogët e kurseve sigurohen që departamenti ka të paktën disa kopje të literaturës së kërkuar në bibliotekë. Studentët kanë mundësinë të takohen me profesorët në orare të caktuara për ta, në mënyrë që të marrin shpjegime ose ndihmë për vështirësitë që hasin në procesin mësimor **[BM2]**. Gjatë pandemisë, pedagogët e AI-së regjistruan leksione për studentët që jetojnë në zona të thella rurale dhe hasnin vështirësi me pajisjet dhe lidhjen në internet. **[Kapitulli I Standardi III.6]**.

5.7 Për të garantuar përfshirjen dhe përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse të AI-së, studentët organizohen formalisht në Këshillin Studentor **[A.18, A.117]**. Këshilli luan një rol të veçantë në pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale, si dhe i përfaqëson në organe të ndryshme të institucionit **[A.1137]**. Ndonëse nuk ka një buxhet specifik, Këshilli Studentor bën kërkesa specifike për veprimtari të ndryshme **[BM2]**. Përfaqësuesi i Këshillit Studentor ka dhënë disa sugjerime rreth kapitullit 5 për përgatitjen e RVV-së, por në përgjithësi nuk ka shumë informacion rreth RVV-së **[BM2]**. Studentët marrin pjesë në mbledhjet e njëjësive kryesore dhe bazë dhe të organeve kolegiale të AI-së. Krahas kësaj, Senati i AI-së ka vendosur të përfshijë në mënyrë aktive përfaqësuesit e studentëve në Këshillin Studentor në mbledhjet e njëjësive të AI-së. Studentët e zgjedhur nga Këshilli Studentor janë pjesë e Senatit Akademik, Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë **[Kapitulli I Standardi III.7]**.

5.8 Në godinën e re, AI-ja ofron hapësira rekreative dhe argëtimi për të garantuar dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës studentore. Veç kësaj, përfaqësuesi i Këshillit Studentor dhe njësitë përkatëse organizojnë veprimtari të ndryshme sociale dhe kulturore, shpesh në kuadër të klubeve studentore. Për sigurinë e studentëve, institucioni ka kontraktuar shoqëri të sigurisë fizike, si Albsig sh.a. **[A.1140]** **[Kapitulli I Standardi III.8]**.

5.9 Zyra e Planifikimit të Karrierës i ndjek studentët nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre, ndërsa zyra e Alumnive ruan kontaktet me ta pas diplomimit **[BM5, BM6]**. Megjithatë, zyra e Alumnive nuk ka rregullore dhe nuk ka shumë informacione rreth alumnive në faqen zyrtare të AI-së, por përdor më tepër rrjetet sociale **[BM5]**. Përmes zyrës së Planifikimit të Karrierës, stafi akademik dhe ai administrativ kanë marrë angazhimin që të zbatojnë politikën e punësimit të studentëve. AI-ja parashikon politika favorizuese për punësimin e studentëve të diplomuar. Gjatë vitit të fundit akademik, përqindja e punësimit të studentëve që ndjekin një cikël të mëtejshëm pas programit Bachelor ishte rreth 100%. Edhe përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat janë përfshirë në përgatitjen e kurrikulave bazuar në kërkesat e tregut, por takimet me alumnit nuk janë të shpeshta, çka do të thotë që duhet të zhvillohen më shumë dhe në mënyrë formale **[BM6]**. **[Kapitulli I Standardi III.9]**.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- AI-ja i mbështet, i nxit dhe i informon vazhdimisht studentët rreth karrierës së tyre profesionale. **[Kapitulli I Standardi III.1].**
- Përqindja e punësimit të studentëve që ndjekin një cikël të mëtejshëm pas programit Bachelor është rreth 100%. **[Kapitulli I Standardi III.9].**
- Institucioni mbështet integrimin në tregun e punës dhe punësimin e studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.3].**
- AI-ja ndjek një politikë mbështetëse për studentët dhe iu kushton vëmendje studentëve me nevoja të veçanta dhe nga kategori të veçanta, duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme dhe bursa **[Kapitulli I Standardi III.4].**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Bashkëpunimi me alumnit dhe Zyrën e Alumnive duhet të koordinohet përmes një dokumenti, që parashton funksionin, kontributin dhe angazhimin e tyre **[Kapitulli I Standardi III.3]**
- Institucioni duhet të alokojë buxhet të dedikuar për të rritur numrin e librave, botimeve dhe buletineve shkencore në format të shtypur në bibliotekë **[Kapitulli I Standardi III.5]**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e evidencave

Lista A e evidencave

Lista e evidencave të mundësuar si pjesë e dokumenteve të vetëvlerësimit të RVV-së. Këto evidenca për RVV-në referohen me shkurtesën A.11..., A. 12..., etj.:

- A. Vetëdeklarimi mbi vërtetësinë e dokumentacionit.pdf
- A. Shkresa përcjellëse e dokumentacionit per Akreditimin Ivodent.pdf
- B. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB).pdf
- C. Raporti i Vetëvlerësimit (RVV).pdf
- D. Raporti për përmbushjen e rekomandimeve te BA.pdf

A.11 VKM për hapjen e Kolegjit “Ivoclar”

A.12 Urdhri i parë institucional dhe për akreditimin e programit

A.13 Urdhër i Ministrit për Statutin e Akademisë “Ivodent”

A.14 Letër aplikimi për akreditim_ASCAL

A.15 Vendim i Rektorit për ngritjen e GVB-së

A.16 Urdhër i MAS-së për të hequr pezullimin

A.17 Vendim i Senatit për Miratimin e Statutit

A.18 Statuti i Akademisë “Ivodent”

A.19 Marrëveshje_MASR & Ivodent

A.110 Vendim i Bordit për Riakreditimin Institucional

A.111 Vendim i Bordit për Riakreditimin e Programit

A.112 Strategjia e zhvillimit të institucionit_18_23_Ivodent

A.113 Marrëveshje_ivodent & upt

A.114 Marrëveshje_ivodent & cit

A.115 Marrëveshje_ivodent & noval

A.116 Marrëveshje_ivodent & shoqata e kristalografisë

A.117 Rregullore e Përgjithshme_ivodent

A.118 Organigrama dhe AI

A.119 Vendim i Senatit për miratimin e akteve rregullatore

A.120 Rregullore e Rektoratit_ivodent

A.121 Rregullore e Senatit Akademik_ivodent

A.122 Rregullore e Bordit të Administrimit_ivodent

A.123 Raport_financiar_Raport i Administratorit për Senatin

A.124 AI-IQE Rezultatet e Pyetësorit të Studentëve

A.125 Verifikim Kapacitetesh_MASR 21

A.125.1 Verifikim Kapacitetesh_MASR 19

A.125.2 Verifikim Kapacitetesh_MASR 20

A.127 Organigrama dhe stafi AI

A.128 Procedura e mbledhjeve të Senatit Akademik_Ivodent

A.129 Procedura e mbledhjeve të Bordit Administrativ

A.130 Procedura e mbledhjeve të departamentit

A.I31 Kërkesë e laborantëve për materiale dentare
 A.I32 Plan aktivitetesh_19-20_ivodent
 A.I33 Plan aktivitetesh_20-21_ivodent
 A.I34 Plan aktivitetesh_21-22_ivodent
 A.I35 Kontratë shërbimesh Audit AI
 A.I36 Raport auditimi
 A.I37 Raport analitik 18-19_ivodent
 A.I37.1 Raport analitik 19-20_ivodent
 A.I37.2 Raport analitik 20-21_ivodent
 A.I38 Rregullore e NJSBC-ivodent
 A.I39 Vendim dhe miratim i Senatit (kuota + kritere) 19-20
 A.I39.1 Vendim dhe miratim i Senatit (kuota + kritere) 20-21
 A.I39.2 Vendim dhe miratim i Senatit (kuota + kritere) 21-22
 A.I39.3 Vendim i Senatit për rialokimin e kuotave 2021 - 2022
 A.I40 Marrëveshje_ivodent & IQE
 A.I41 Dokument financimi Altin Mele nga COST CA16112 për takimin në Gdansk
 A.I42 Projektpropozime të zbatuara në programe kombëtare dhe ndërkombëtare
 A.I43 Propozim i Departamentit të Prostodontikës për Hapjen e një Programi Masteri në TDD
 A.I44 Vendim i Senatit për Hapjen e Programit në TDD
 A.I45 Projektpropozim për hapjen e TD-së
 A.I46 Vendim i Senatit për hapjen e TD-së
 A.I47 Propozim i Departamentit të Prostodontikës për Riorganizimin e Programit të TLD-së
 A.I48 Procedurat për ndryshime në programin e TLD-së
 A.I49 Vendim i Senatit për riorganizimin e TLD-së
 A.I50 Procedura e përzgjedhjes së stafit akademik
 A.I51 Lista emërore e PAK dhe PAE
 A.I52 Vendim i Senatit për ngritjen e një grupi për hartimin e dokumentacionit
 A.I53 Vendim i Senatit për miratimin e strategjisë së zhvillimit
 A.I54 Vendim i Senatit për miratimin e strukturës akademike 2021 - 2022 (2 vendime)
 A.I55 Rregullore e Fakultetit_ivodent
 A.I56 Studim i Tregut të Punës
 A.I57 Marrëveshje_ivoclar Ltd & ivodent
 A.I58 Marrëveshje e Akademisë "Ivodent" BBW për Njohjen e Diplomave të Studentëve AI në Gjermani
 A.I59 Punë e Drejtë & Studim AI
 A.I60 Analiza e Përfitimeve nga Marrëveshjet me IAL-të dhe Partnerë të Tjerë
 A.I61 Bashkëpunim me Kryqin e Kuq
 A.I62 Marrëveshje Ivodent & FMD_UMT
 A.I63 Marrëveshje_ivodent & AU
 A.I64 Marrëveshje Ivodent & U_Aldent
 A.I65 Marrëveshje_ivodent & albmedtech
 A.I66 Marrëveshje Mirora Ngjelina & ivodent
 A.I67 Marrëveshje CAA - Akademia "Academy" (09.04.2020)

A.168 Punësimi i studentëve të TLD-së 2019-2020
A.169 Punësimi i studentëve të TLD-së 2020-2021
A.170 Kontratë pune Igli Qoshja
A.171 Marrëveshje me Dorina Mele Co
A.172 Kontratë_Ivodent & VODAFONE
A.173 Listë e pedagogëve të huaj & të ftuar
A.174 Konferenca ICMS 2021
A.175 Lista e trajnimeve të zhvilluara
A.176 Udhëzues për Mësimdhënien Online (Manuali i Përdoruesit të GOOGLE Classroom)
A.177 Ndërfaqja e kursit për mësimdhënien online
A.178 Rregullore e aktiviteteve_federata
A.179 Aktivitete_Lista e regjistrimit për burrat që duan të luajnë mini-futboll
A.179.1 Aktivitete_Maratonë 2021
A.179.2 Aktivitete ndeshje futbollit midis studentëve të Akademisë
A.179.3 Aktivitete sociale (turne)
A.180 Lista e botimeve
A.181 Emaile drejtuar Uni Stip dhe Gdansk për Marrëveshjen ERASMUS+
A.182 Mobiliteti_në_nivelin institucional_AI
A.183 Konferencat e zhvilluara
A.184 Workshope_19_21
A.185 Departamentet rregullatore
A.186 Mbledhje departamenti për diskutimin e buxhetit
A.187 Projektpropozim për hapjen e programit Bachelor në Teknika Laboratorike në Ortodonci (28.12.2020)
A.188 Stafi Akademik 19 -20
A.188.1 Stafi Akademik 20 -21
A.188.2 Stafi Akademik 21 -22
A.189 Kontratë_tip PAE
A.189.1 Kontratë tip PAK
A.189.2 Kontratë tip për stafin joakademik
A.190 CV Stafi Akademik PAE
A.190.1 CV Stafi Akademik PAK
A.191 Udhëzim i MASR-së Nr. 29 për shpërndarjen e ngarkesës mësimore.
A.192 Broshurë Alvodent (1)
A.192.1 Broshurë Alvodent (2)
A.192.2 Broshurë Alvodent (3)
A.193 Lista e pagesave Mars/Maj 2020
A.194 Raport vjetor për aktivitetet didaktike online gjatë periudhës së COVID-19.
A.195 Shembuj - Mbulimi i tarifës së botimit të Lorenzit.
A.196 Tarifa për pjesëmarrjen në konferencë
A.197 Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit_ivodent
A.198 Rregullore e Këshillit të Etikës_ivodent
A.199 Procedura e miratimit të buxhetit
A.1100 Infrastruktura e IT-së dhe marrëveshja me Google

A.I101 Raport i Infrastrukturës së Ivodent
 A.I102 Planimetria e Akademisë
 A.I103 Fotografi të faqeve të internetit, Facebook-ut, Instagram-it
 A.I104 Biblioteka Online R4L_licence_2021
 A.I105 Pyetësor i Studentit AI
 A.I106 Raport i Infrastrukturës Laboratorike
 A.I107 Përmbledhje_Statistika_2020-2021
 A.I108 Rregullore_Sekretaria_Ivodent
 A.I109 Rregullore e programit të studimit të TD-së
 A.I110 Rregullore e programit të Masterit Profesional në Teknika Dentare Digjitale
 A.I111 Plani i masave organizative 20.05.2021 për riorganizimin e mësimin gjatë pandemisë
 A.I112 Këshillim_Karriere_ivodent_Manual
 A.I113 Broshurë informuese për AI
 A.I114 Aktivitetet e Orientimit të Studentëve_Zyra e Karrierës.
 A.I115 Urdhra për hapjen e programeve të reja të studimit
 A.I116 Dosja e programit të studimit_BSC
 A.I117 Kurrikula e vjetër dhe e riorganizuar e TLD-së
 A.I118 Programi i kursit_TLD
 A.I119 Format i programit TDD
 A.I120 Rregullore e Programit të Riorganizuar të Studimit_TLD
 A.I121 Dosja e programit të studimit_MP
 A.I122 Kurrikula e Masterit Profesional në TDD
 A.I123 Diploma/Suplementi i Diplomës
 A.I124 Mobilitet për studentët që kryejnë praktikën në Gjermani (bileta, fatura, kontratë stazhi)
 AI 125 Shembull diplome/njohjeje programi në Gjermani
 AI 126 Studentë të punësuar jashtë vendit
 AI 127 Final_Shembull i realizimit të praktikës
 A.I128 Final_Kontratë për praktikë profesionale në Gjermani BIOSA Valentin
 A.I129 Kontratë për kryerjen e praktikës profesionale II
 A.I130 Udhëzues studimi për provimin në teknika dentare
 A.I131 Shembull i fletës së provimit
 A.I132 Urdhër i MASR-së për miratimin e programit të riorganizuar.
 A.I133 Njoftime në rrjete sociale për trajnime
 A.I134 Statistikat e studentëve të regjistruar gjatë viteve
 A.I135 Shembull i programit TD
 A.I136 Rregullore të brendshme të bibliotekës_ivodent
 A.I137 Rregullore e Këshillit Studentor
 A.I138 Kontratë Shërbimesh - AI_Bashkia e Tiranës
 A.I139 Vendim i Rektorit për ngritjen e GVB-së
 A.I140 Marrëveshje me ALBSIG JSC
 A.I141 Certifikatë studentësh

Lista B: Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës

Mbledhjet janë referuar në raport duke përdorur shkurtimet **BM1**, **BM2**, etj.
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Koordinatorin Institucional.

BM1: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Rektorin.

BM2: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup studentësh të 3 programeve.

BM3: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup të stafit akademik.

BM4: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon drejtuesit dhe stafin e lartë.

BM5: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup të stafit mbështetës dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

BM6: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon partnerët e jashtëm dhe alumnit.

BM7: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit

BM8: Tur në mjediset e Akademisë